



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Ekonominë dhe Financat

PROCESVERBAL

Tiranë, më 07.11.2018, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Erion Braçe – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbalit;
2. Prezantimi i projektligjeve të paketës fiskale:
 - “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar””
 - “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9975, datë 28.07.2008 “Për taksat kombëtare”, i ndryshuar””
 - “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar””

Marrin pjesë:

Erion Braçe, Anastas Angjeli, Evis Kushi, Antoneta Dhima, Blerina Gjylameti, Ilir Xhakolli, Xhavit Bushaj, Arben Pëllumbi, Reme Lala, Ervin Bushati dhe Roland Xhelilaj.

Mungojnë:

Jorida Tabaku, Edmond Spaho, Agron Shehaj, Fatbardha Kadiu, Nadire Meçorapaj, Dashamir Shehi, Edmond Haxhinasto dhe Përparim Spahiu.

Të ftuar:

Arben Ahmetaj - Ministër i Financave dhe Ekonomisë
Nikolla Lera - Drejtor i Përgjithshëm i Politikave Makroekonomike në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Endrit Lami – Drejtor në Drejtorinë e Politikave Makroekonomike në Ministrinë e
Financave dhe Ekonomisë

Enkeleda Kuci -

Arbër Lleshi – Këshilltar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

HAPET MBLEDHJA

Erion Braçe – Mirëmëngjesi të gjithëve!

Fillojmë mbledhjen e Komisionit për Ekonominë dhe Financat të Kuvendit. Siç jeni njoftuar, në rendin e ditës së sotme të punës së komisionit kemi për të shqyrtuar 3 projektligje:

1. Prezantimi, relatimi dhe diskutimi në parim i projektligjit “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar””.

2. Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9975, datë 28.07.2008 “Për taksat kombëtare”, i ndryshuar””.

3. Projektligji “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar””.

Për këtë arsye, ndodhet në komision për të prezantuar projektligjin ministri i Financave dhe Ekonomisë, zoti Arben Ahmetaj.

Relatore e komisionit për këto 3 projektligje është zonja Blerina Gjylameti.

Do të procedojmë me prezantimin e secilit projektligj dhe më tej, do të flasë relatorja e komisionit. Më pas do të vijojmë me diskutimin në parim.

Fillojmë me prezantimin e projektligjit “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar””.

Fjalën e ka zoti ministër!

Arben Ahmetaj – Kryetar, kam një pyetje. Ju thatë se sot do të bëni vetëm diskutimin në parim, apo edhe diskutimin nen për nen?

Erion Braçe – Zoti Ministër,

Sot do të diskutojmë vetëm në parim. Projektligjet do të diskutohen nen për nen në komision, vetëm pasi të votohen në parim në seancë plenare në datën 23. Më pas, do të rikthehen për t’u diskutuar nen për nen në komisione.

Arben Ahmetaj – Unë mendova se ndoshta mund të bënim edhe diskutimin nen për nen, që të avanconim. Megjithatë, s’ka problem.

Erion Braçe – Nuk mund ta diskutojmë sot nen për nen, sepse nuk ka lejon Rregullorja e Kuvendit. Janë dy votime në parlament: votimi në parim dhe ai nen për nen.

Rregullorja e Kuvendit thotë se pasi të votohet në projektligji parim, bëhet diskutimi nën për nen. Mund të ndodhë, bie fjala, që projektligji nuk votohet në parim në seancë plenare dhe kështu nuk kemi pse ta diskutojmë nën për nen.

Fillojmë me prezantimin e projektligjit “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar””.

Arben Ahmetaj – Dakord.

Atëherë, meqë dje bëmë një parashtrim edhe të paketës fiskale në parim, unë po e shkurtoj fjalën time për t’u lënë më shumë hapësirë pyetjeve dhe diskutimeve.

Projektligji “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat””, do të fokusohet në lehtësimin e barrës fiskale mbi dividendin, i cili, siç e thamë, do të zbresë nga 15 % në 8 %.

Ndërkohë, do të ofrojmë incentivim për shpërndarjen e fitimeve të kapitalizuara ose jo, të viteve të kaluara me normën e re të dividendit, pra në thelb do të bëjmë një retrospektivë me normën 8%.

Lehtësimi i ngarkesës fiskale për të punësuarit, duke zgjeruar fashën e të punësuarve, që tatohet me shkallën 13 %, nga paga 130 mijë lekë në pagën 150 mijë lekë.

Ndërkohë, do të qartësojmë dhe do të zgjerojmë konceptin mbi burimin e të ardhurave në RSH me qëllim mbrojtjen e bazës tatimore.

Do të sanksionojmë me ligjin e brendshëm tatimor të së drejtës sonë për të tatuar në Shqipëri të ardhurat e realizuara nga shitja e drejtpërdrejtë apo e tërthortë e aseteve ose të të drejtave, që derivojnë nga pasuritë e paluajtshme të vendosura në territorin e RSH-së (shembulli që unë solla për Bankers-in dhe jo vetëm).

Do të bëhet një kufizim sasior në lidhje me shpenzimet për dieta. Ishte parë një lloj shmangie nga baza tatimore (paga e dietave), e tatimit mbi të ardhurat personale. Një pjesë e tyre numërohen si të zbritshme. Në këtë rast ne do t’i kufizojmë shpenzimet për dieta.

Nenet 1, 3, 5 dhe 6 parashikojnë rregullimin e taksimit të jorezidentëve, duke siguruar si një burim të ardhurash të tatueshme në Shqipëri të ardhurat e kësaj kategorie në lidhje me shitjet e kuotave të kompanive apo aktiveve që ndodhen në Shqipëri. Pra, është një kombinim edhe i asaj që thashë më parë për pasuritë e paluajtshme.

Ndërkohë, në këtë referencë, ju kam sjellë gjithmonë shembullin e shitjes së aksioneve të Bankers-it apo nëse doni, edhe të aeroportit “Nënë Tereza”.

Nenet 2, 7 dhe 8 trajtojnë normën e reduktuar të dividendit.

Neni 4 kufizon shpenzimet e interesit. Këto janë elementet bazë, që prekin tatimin mbi të ardhurat.

Ky ishte edhe prezantimi im në aspektin e politikës ekonomike dhe të politikës fiskale. Ndryshimet në këtë ligj janë në vazhdimin e uljes së ngarkesës fiskale për sipërmarrjen dhe për qytetarët. Ia vlen të bëjmë këtë retrospektivë, që e bëmë edhe dje. Brenda vitit 2018 kemi avancuar një paketë të plotë për vitin 2019 dhe në vazhdim, ku përfshihen: ulja e tatimfitimit nga 15% në 5% për shoqëritë e bashkëpunimit bujqësor; ulja e TVSH-së në normë të reduktuar nga 20% në 6% për agroturizmin dhe, ndërkohë, njohja e logjikës së zbritshme, të rimbursueshme të TVSH-së edhe për fermerin e vogël, edhe për SHBB-të; ulja e tatim fitimit nga 15% në 5% për agroturizmin; rritja e nivelit të tatueshëm me 15% nga 8 milionë në 14 milionë. Pra, çdo biznes me xhiro mbi 14 milionë do të jetë i taksuar me 15% tatim mbi fitimin. Nën këtë prag deri në 5 milionë, do të jetë i taksuar me 5% tatim mbi fitimin dhe nën 5 milionë xhiro, do të taksohet me 0% tatim mbi fitimin.

E gjithë paketa, në këndvështrimin tim personal, por edhe si ministër i Financave, besoj se kemi arritur të ofrojmë një platformë jashtëzakonisht shumë harmonike me sipërmarrjen dhe me qytetarët me ulje të konsiderueshme, të qenësishme të paketës fiskale.

Dua ta alertoj këtë komision, i cili duhet të jetë i vëmendshëm ndaj të gjitha tentativave që mund të ketë përtej këtij komisioni, sepse ky komision është barazvlefshmërisht i përgjegjshëm me qeverinë për sa i përket konsolidimit fiskal. Ka ardhur koha të heqim dorë nga përjashtimet fiskale (nga TVSH-ja, nga tatimfitimi dhe nga taksat e tjera), sepse kemi krijuar tashmë një ecuri të konsolidimit të shëndetshëm, një trend uljeje të konsiderueshëm të bazës fiskale. Jemi në momente shumë të rëndësishme të uljes së borxhit publik. Besoj se ky komision është diga kryesore e çdo lloj tentative legjitime për të krijuar përjashtime fiskale. Duhet ta dini që Shqipëria edhe në analizat që bëjmë së bashku me FMN-në, është vendi me përjashtimet fiskale më të mëdha në rajon. Ne mbledhim edhe për shkak të përjashtimeve nga taksat, rreth 27,7% të PBB-së dhe kemi një masë të konsiderueshme në raport me PBB-në përjashtime nga taksat. Ky është komisioni i vetëm në këndvështrimin tim, që duhet të kthehet në një pengesë të kërkesave legjitime, por diku joracionale, diku edhe racionale të përjashtimeve fiskale.

Faleminderit!

Erion Braçe – Faleminderit, zoti Ministër!

Të jeni i bindur që ky komision është shumë i vëmendshëm ndaj çdo lloj çështjeje, jo vetëm ndaj asaj që ju kërkoni.

Fjalën e ka zonja Gjylameti, për relatimin në emër të komisionit për projektligjin “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar””.

Blerina Gjylameti – Faleminderit, kryetar!

Projektligji “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar””, ka si qëllim rishikimin e dispozitave të ligjit, që rregullon tatimin mbi të ardhurat personale dhe tatimin mbi fitimin në Republikën e Shqipërisë. Ndryshimet dhe shtesat propozohen jo vetëm për të përmirësuar procedurat e mbledhjes së tatimit, por edhe për të vazhduar më tej politikën e lehtësimit të barrës fiskale për kategori të veçanta, si dhe për të mbrojtur bazën tatimore në vendin tonë. Konkretisht, projektligji i propozuar nga Këshilli i Ministrave për ndryshimin e legjislacionit të tatimit mbi të ardhurat, përmban dispozitat e mëposhtme:

1. Në nenin 1 të projektligjit propozohet të riformulohen dispozitat e nenit 4 “Burimi i të ardhurave”, të ligjit, që lidhen me të ardhurat nga pronësia dhe kalimi i pronësisë për pasuritë e paluajtshme, duke zgjeruar bazën e tatueshme në vend nëpërmjet përfshirjes në këtë kategori edhe të ardhurat nga të drejtat për shfrytëzimin e pasurive minerale, hidrokarbure apo burimeve natyrore tokësore dhe ujore, si dhe aksioneve ose interesave të ngjashme me to.

2. Në nenet 2, 7 dhe 8, të projektligjit propozohet lehtësimi i barrës fiskale për 20 mijë biznese ose mbi 50 mijë investitorë të kapitalit nëpërmjet uljes së normës së tatimit mbi dividendin, të ardhurave që rrjedhin si fitim i ortakut dhe nga ndarja e fitimit nga 15% në 8%. Kjo masë vlerësohet të ketë impakt pozitiv në të ardhurat buxhetore të vitit 2019 me rreth 4,5 miliardë lekë, si rrjedhojë edhe e përcaktimit të bërë në dispozitat kalimtare për aplikimin e normës 8% për fitimet e pashpërndara, por të akumuluar apo të kapitalizuara të viteve të fundit.

3. Në nenin 4, të projektligjit propozohet mosnjohja si shpenzime të zbritshme në përcaktimin e fitimit të tatueshëm të shpenzimeve për dieta, që tejkalojnë 50% të fondit të pagës bruto vjetore, edhe kjo masë në kuadër të rregullimeve dhe angazhimeve për minimizimin e shmangieve dhe ruajtjen e bazës së tatueshme.

4. Në nenin 5, të projektligjit propozohet të shtohet një nen i ri në ligjin aktual, i cili i vendos detyrim për personin juridik për të paguar tatimin mbi fitimin, në rastin e ndryshimit më shumë se 20% në vlerë, të pronësisë direkte dhe/ose indirekte të kapitalit aksionar, të kuotave ose të drejtave të votimit, njoftimin e administratës tatimore brenda 45 ditëve për detajet e ndryshimit, si dhe përjashtimin nga pagimi i tatimit për çdo ndryshim.

Gjithashtu, në këtë nen vendoset detyrimi për njoftimin e administratës tatimore brenda 45 ditëve edhe për ndryshimet e pronësisë prej 10% ose më shumë të kapitalit ose të të drejtave të votës të personit juridik, duke përcaktuar më pas edhe aplikimin e penalteteve konform ligjit të procedurave tatimore për rastet e mosnjoftimit.

6. Neni 6, propozon shtimin e një neni të ri për përfshirjen e personave jorezidentë në personat që i nënshtrohen tatimit mbi fitimin për fitimet e realizuara nga shitja e aksioneve apo e interesave të ngjashme, vlera e të cilave buron nga pasuri të paluajtshme në Republikën e Shqipërisë. Këta individë do të detyrohen të plotësojnë më pas deklaratën e të ardhurave të tatueshme, brenda datës 31 mars të vitit pasardhës.

7. Ndërsa me ndryshimin e pasqyrës nr. 1 të ligjit, realizohet ulja e ngarkesës fiskale për të punësuarit, duke e rritur fashën e të ardhurave, që taten me normën 13%, nga 130 000 lekë/muaj në 150 000 lekë/muaj, nga e cila do të përfitojnë rreth 15 400 punëmarrës, shumica e të cilëve punojnë në sektorin privat. Kjo ulje e tatimit shoqërohet edhe me disa ndërhyrje në ligjin për procedurat tatimore, me qëllim limitimin e abuzimeve me shmangien tatimore në pagat e larta. Miratimi i pasqyrës së ndryshuar do të rezultojë me një efekt negativ në buxhetin e shtetit prej 319 milionë lekësh.

Duke qenë se këto ndryshime së bashku me ndryshimet e miratuara në muajin korrik për uljen e tatimfitimit nga 15% në 5% për tatimpaguesit me qarkullim nga 8 milionë deri në 14 milionë lekë dhe për shoqëritë e bashkëpunimit bujqësor, si dhe aplikimi i një norme të reduktuar të tatimfitimit në masën 5%, për një periudhë 10-vjeçare, për strukturat akomoduese në agroturizëm, propozojnë lehtësira fiskale të qenësishme për zhvillimin e sektorëve kyçe të ekonomisë shqiptare, që do të garantojnë zhvillim të qëndrueshëm ekonomik, duke siguruar punësim dhe më shumë të ardhura e më shumë mirëqenie për qytetarët shqiptarë, i propozoj anëtarëve të komisionit miratimin e projektligjit në parim duke marrë parasysh propozimet e mëposhtme:

Për sa i përket propozimit të parë, disa ndryshime për mbrojtjen e pagave më të ulëta, duke marrë parasysh faktin që në këto vite, pra në vitin e pestë të PS-së në pushtet, kemi pasur herë pas here ngritje të këtyre pagave dhe në mënyrë të tillë, ato hyjnë në fashat në të cilat ato e paguajnë tatimin mbi të ardhurat.

Propozimi i dytë, ka të bëjë me uljen e tatimit mbi dividendin, pra duke marrë parasysh faktin që ka një ulje mbi dividendin nga 15% në 8%, propozojmë të rishikohet edhe një herë kjo politikë me qëllim që të kemi zerim të tatimit mbi dividendin për të gjithë dividendin e riinvestuar me qëllim që të kemi një rritje dhe një zgjerim të aktivitetit ekonomik, pra jo vetëm ulje për dividendin e pashpërndarë për investim.

Për sa i përket tatimin mbi të fitimin 30% nga të ardhurat bruto nga lojërat e fatit, një angazhim i marrë në seancën e fundit, ku u miratua edhe ligji mbi ndalimin e lojërave të fatit.

Faleminderit!

Erion Braçe – Faleminderit, zonja Gjylameti!

Kalojmë në pyetje!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, pasi të mbarojmë pyetjet. Nuk funksionon kështu. Do të vazhdojmë me pyetjet dhe pastaj do të kalojmë në diskutime.

Arben Ahmetaj – Zonja bëri disa propozime.

Erion Braçe – Jo, Zonja nuk bëri propozime, por foli si relatore e komisionit.

Arben Ahmetaj – Më falni, kryetar!

Zonja bëri 3 propozime.

Zonja bëri propozim për dividendin, për lojërat e fatit dhe për të ardhurat personale për pagat e ulëta.

Erion Braçe – Edhe?

Arben Ahmetaj – Atëherë, duhet t'i përgjigjem.

Erion Braçe – Patjetër, do t'i përgjigjeni. Të vazhdojmë me pyetjet dhe kur të kalojmë në diskutime, mund ta merrni fjalën sa herë të doni për t'u përgjigjur.

Arben Ahmetaj – Dakord.

Unë për këtë punë kam ardhur, apo jo?

Erion Braçe – Po, patjetër, për të folur.

Urdhëroni, për pyetje!

Evis Kushi - Faleminderit, kryetar!

Natyrisht, lehtësimi i ngarkesës fiskale është një nga objektivat e kësaj maxhorance, që është reflektuar edhe në programin qeverisës 2017-2021. Edhe kjo paketë fiskale e reflekton shumë mirë këtë objektiv.

Ndërkohë, unë kam një pyetje që lidhet me dividendin, sepse kam përshtypjen që pas çdo ndryshimi dhe pas çdo lehtësie fiskale, duhet të qëndrojnë disa argumente dhe disa analiza për të parë efektet e pritshme.

Një nga ndryshimet e propozuara në këtë projektligj është ulja e normës mbi dividendin, që do të zbrësë nga 15 % në 8 %. Unë desha të di se cilat janë argumentet që qëndrojnë pas këtij propozimi, sepse ishim po ne që e propozuam normën mbi dividendin, 15% dhe është e nevojshme të dimë, nëse është bërë një analizë se si ka funksionuar. A ka pasur ndonjë problem me nivelin 15% që sot po propozojmë uljen në 8 %? Çfarë efekti do të ketë ky ndryshim qoftë në të ardhurat në buxhetin e shtetit, qoftë në rritjen e konsumit, e kështu me radhë në të gjithë treguesit e ekonomisë?

Së dyti, cila është arsyeja që ky ndryshim në projektligj do të ketë edhe efekte prapavepruese, pra që propozohet kjo masë të jetë e vlefshme edhe për dividendët, të cilët nuk janë shpërndarë në vitet e mëparshme?

Faleminderit!

Erion Braçe – Urdhëroni, zoti Ministër!

Arben Ahmetaj – Patjetër, është bërë një analizë shumë e detajuar. Mesatarisht janë 21 mijë persona juridikë tatimpagues, të cilët dorëzojnë deklaratën e tatimfitimit. Nga këta, 12 900 tatimpagues ose 61% e tyre deklarojnë fitim të tatueshëm. 8100 tatimpagues ose 39% e totalit të kompanive të regjistruara ose kanë zero veprimtari, ose nuk realizojnë fitim, ose janë me humbje korrente.

Nga 12 900 tatimpagues, të cilët deklarojnë fitim të tatueshëm nga veprimtaria, 1456 tatimpagues ose 11% e tyre, deklarojnë shpërndarje dividendi. Kjo përbën vetëm 7% të numrit total të tatimpaguesve për tatimfitimin.

Ndërkohë, siç e theksova, tatimi mbi dividendin është ndër vite relativisht i vogël dhe ka pasur edhe një tendencë (akoma minore, por gjithsesi e prekshme) për të spostuar qendrat e kompanive jashtë Shqipërisë vetëm për dividendin, në mënyrë që të përfitojnë nga tatimi më i ulët mbi dividendin. Rajoni ka nivele shumë më të ulëta se 15%. Kosova e ka zero; Bosnja,

Bullgaria, Rumania, e kanë 5%; Mali i Zi 9%; Maqedonia 10%; Kroacia 12%. Ndërkohë, është e vërtetë që ka një pjesë të madhe të kompanive që praktikisht janë të huaja dhe përfitojnë nga marrëveshjet e shmangies së tatimit të dyfishtë dhe zbresin në nivelin 5%. Pra, është një situatë e pashmangshme, ku praktikisht një pjesë e kompanive, për hir të së vërtetës, gjeneron fitime të konsiderueshme. Për shembull, në vitin 2016 fitimi i gjeneruar nga kompanitë e huaja është 47,4 miliardë me taksim 15% dhe, praktikisht, përfitimi i tyre nga marrëveshjet e shmangies së tatimit të dyfishtë është i drejtpërdrejtë. Në vitin 2017 fitimi ishte 48,3 miliardë dhe është e njëjta situatë, ndërkohë që pjesa tjetër, ku janë gati 330 miliardë fitime, do të taksohej me 15%. Po të shohësh dividendin, ai ka qenë minimal.

Prandaj, vendosëm të bëjmë një balancim, qoftë edhe me të ardhurat personale, që iu referova dje, ku tatimi maksimal është 23%, ndërkohë që duke iu referuar kolonës së tatimfitimit dhe dividendit, 15-a dhe 8-a bëjnë një balancim midis të dyjave, kapitalit dhe punës.

Ndërkohë, po t'i referohemi tatimit mbi të ardhurat personale, duke iu referuar edhe asaj që tha zonja Gjylameti si propozim, do të ishte tejet e gabuar dhe do të prishte sistemin në qoftë se do të hynim sërish te pagat e ulëta, siç referuat ju, ndërkohë që ky është nga të vetmet vende që ka përjashtuar 30-mijëlekëshin.

Të dytën po jua them tani, se kam të gjithë taksën efektive këtu. Taksa efektive, nga 300 mijë lekë (po flas me të vjetrat, që qytetarët ta kenë më të thjeshtë për të më ndjekur) në 400 mijë lekë pagë, taksa është 1,96%; nga 400-500 mijë lekë është 4,4%; nga 500-600 mijë lekë është 5,9%; nga 600-700 mijë lekë është 6,93%.

Ky komision duhet të jetë partneri i parë i konsolidimit fiskal dhe të thotë se rreth 60% të punonjësve të këtij vendi nuk paguajnë taksa mbi të ardhurat personale, sepse janë nën 300 mijë lekë. Ky është edhe problem evazioni, kjo nuk diskutohet, por ka ardhur duke u ulur. Jua kam thënë, 42% e punonjësve të VIP-at, ka qenë (ka filluar të përmirësohet pas fushatës që ndërmori Ministria e Financave) para një viti kanë qenë nën 300 mijë lekë. Tashmë e kemi sistemin tejet progresiv. Kemi nxjerrë nga buxheti i shtetit (dhe kemi bërë shumë mirë) 120 milionë dollarë. Nuk ka nevojë ta komplikojmë sistemin dhe ta bëjmë të padrejtë.

Në fakt, diskutimi mund të ishte (por nuk duhet të jetë) se çfarë do të bëjmë sot me 300-mijëlekëshin? Do ta ulim? Sepse po rrisim edhe numrin e të punësuarve, edhe pagat. Nuk është ky diskutimi, por nuk duhet të jetë as ai diskutimi.

Për sa i përket dividendit zero, jam i bindur që ky komision do të më mbështesë. Nuk mund të shkojë dividendi zero në retrospektivë. Përkundrazi, le të rrijë 8%, aq sa është. Po bëjmë një relaksim, për të lejuar sipërmarrjen të amnistojë ato që ka fituar, jo në kuptimin e evazionit, por në kuptimin e tërheqjes së fitimit si dividend. Ju kërkoj ndjesë që përdor këtë lloj diskursi, por nuk është logjike ta bësh zero! Pse? Dakord, le ta balancojmë. Debati është i shëndetshëm, nga 15% në 8%. E kanë kërkuar 5%, por është normale dhe legjitime që sipërmarrja të kërkojë ulje taksash, siç është legjitime për një qeveri të shikojë interesin e përgjithshëm publik.

Për lojërat e fatit do të bëjmë një diskutim teknik së bashku. Të gjykojmë se ku jemi me ngarkesën fiskale konkrete, se jam i bindur që ju, ashtu si ne, keni nevojë ta shihni aty gjithë ngarkesën fiskale, si është ajo konkretisht sot. Në qoftë se ngarkesa fiskale është e disbalancuar me rajonin, me vendet e tjera dhe me *best practice*, hajde ta vendosim, por nuk është këtu diskutimi! Hajde ta diskutojmë teknikisht gjatë ditëve atë që ju thatë. Kemi marrë angazhimin ta konsiderojmë, sepse jam i bindur që komisioni dhe unë do të ulemi teknikisht dhe do t'i shohim një nga një gjërat, që më pas të arrijmë në konkluzion. Për dy të parat, ju kërkoj ndjesë dhe duhet të mirëkuptoni (se unë pjesë e këtij grupi jam), por jam absolutisht kundër që të preket.

Erion Braçe – Ishin pyetjet e zonjës Kushi, pavarësisht se ministri u përgjigj për tjetër gjë. Kështu që do të vazhdojmë me pyetjet, pastaj në diskutime...

Arben Ahmetaj – Kryetar, zgjerova përgjigjen, jo se u përgjigja për tjetër gjë.

Erion Braçe – Më fal, edhe një herë!

Zoti Ministër, këtë mbledhje e drejtoj unë dhe e drejtoj sipas Rregullores së Kuvendit. Sipas Rregullores së Kuvendit, prezantoni ju, ka relatim, ka pyetje, ka përgjigje nga ju dhe më pas diskutime. Në rast se doni ta merrni fjalën për çdo gjë që thuhet këtu... Pa asnjë lloj diskutimi, vetëm kur ju adresohet pyetje! Në rast se nuk ka adresim me pyetje për çështje të caktuara, kur të bëhen diskutimet merreni fjalën për gjithçka dhe flisni për gjithçka.

Ka më pyetje?

Po, urdhëroni, zonja Dhima.

Antoneta Dhima – Faleminderit, zoti kryetar!

Faleminderit, zoti Ministër!

Kam një pyetje. Sa janë efektet në buxhetin e shtetit, si rezultat i ndryshimit të kufirit të sipërm të tatimit mbi të ardhurat personale nga punësimi? Sepse ju jepni një informacion, që ulet barra tatimore për 15 mijë e 400 punonjës.

Arben Ahmetaj – 320 milionë...

Antoneta Dhima – Faleminderit!

Erion Braçe – Ka pyetje tjetër?

Kam unë disa pyetje.

Pyetja e parë lidhet me dividendin dhe me dispozitën kalimtare që ju keni vendosur këtu, në të cilën thoni se norma e tatimit mbi dividendin në shkallën 8% do të aplikohet edhe për fitimet e pashpërndara, të realizuara gjatë vitit 2018 e më parë, përfshirë rezervat dhe fitimet e kapitalizuara, me kusht që tatimi mbi dividendin, që u përket fitimeve të pashpërndara në vitin 2017 e më parë, të paguhet brenda datës 30 shtator 2019, ndërsa tatimi mbi dividendin për fitimin e vitit 2018, të paguhet brenda datës 20 gusht 2019.

Pyetja ime është: pse duhet t'i japim efekt paraveprues kësaj mase që ndërmarrim, duke filluar nga viti 2019?

Pyetja e dytë: a keni ju një analizë të të dhënave? Sa është fitimi i pashpërndarë para vitit 2017, që ju prisni të fillojë të deklarohet për efekt të kësaj mase?

Pyetja e tretë: kjo masë ju ngjan si amnisti apo si një politikë fiskale që duhet të përfshinte vitin 2019 e më pas?

Urdhëroni!

Arben Ahmetaj –Atëherë, fitimi i pashpërndarë nga 2015-a në 2017-n, është 393 miliardë lekë. Duhet të kemi parasysh që e kam përjashtuar fitimin e kompanive të huaja, që janë nën regjimin e përjashtimit të taksimit të dyfishtë. Arsyeja pse shkojmë në retrospektivë, është për t'i dhënë një mundësi... Ato që janë investuar, janë investuar, kryetar. Ato nuk mund të materializohen dot në dividend. Po flasim për ato që kanë krijuar rezerva, pra që kanë fryrë rezervat dhe i kanë kapitalizuar ndër vite vetëm për të mos shpërndarë dividend për shkak të taksës. Pra, është një logjikë, le të themi, amnistimi, jo të evazionit, por të një mosveprimi, pra të mosshpërndarjes, që pretendohet se ka ardhur për shkak të taksës së lartë prej 15%. Kjo është logjika.

Sigurisht, po ta shikoni edhe në ligj, ajo është *one of*, pra do të bëhet vetëm një herë dhe në vazhdimësi, sigurisht që regjimi do të jetë ai që kemi të sanksionuar me ligj. Këto ishin...

Erion Braçe - Pyetja tjetër, lidhet përsëri me dividendin. Dëgjova disa të dhëna nga ju dhe në mos gaboj referuat që vetëm 7% e 12 mijë e 800 kompanive që realizojnë fitim, deklarojnë dividend, apo jo?

(Ministri Arben Ahmetaj flet pa mikrofon)

Dakord.

Unë e kam më të thjeshtë pyetjen dhe nuk e shtri te 21 mijë...

Në 100 kompanitë me xhiron më të madhe në këtë vend, sa për qind prej tyre deklarojnë dividend?

Arben Ahmetaj – Këtë llogari do t’jua jap me shkrim, në mënyrë që praktikisht të ruajmë edhe detyrimin ligjor për të përmendur kompanitë që nuk janë publike, se ka kompani që janë publike dhe kompani që nuk janë publike, pra sh.a.-të dhe kompanitë e tjera, që... Gjithsesi, do t’jua vë në dispozicion. Një problem të kësaj natyre e kemi me kompanitë shtetërore dhe kompanitë e mëdha private, që bëjnë pjesë te 100 kompanitë. Një pjesë e mirë e grupit të 100 kompanive janë të huaja dhe praktikisht janë jashtë regjimit të 15%-ëshit. Brenda ditës së sotme, deri pasdite, do ta keni atë listë.

Erion Braçe – Faleminderit!

Pyetja e tretë lidhet përsëri me çështjen e dividendit. Në relacionin që shoqëron projektligjin, ju thoni se reduktimi i normës së dividendit nga 15 në 8% prezantohet si një masë që do të ulë ngarkesën fiskale të investitorëve, duke nxitur alokimin më të shpejtë të kapitalit në ekonomi dhe shtimin e konsumit.

Ju thatë se janë gati 393 miliardë lekë fitime të realizuara gjatë kësaj periudhe e të tjera me radhë...

A mund të më thoni sa prisni ju? A e keni matur apo e keni ndier interesin e këtyre kompanive? Në ç’masë mund të realizohet kjo që ju thoni, alokimi i shpejtë i kapitalit dhe shtimi i konsumit, që do të vijë nga ky favor fiskal që do të bëhet?

Arben Ahmetaj – Është logjikë financiare dhe fiskale. Po t’i referohemi sot sistemit bankar, që korporatave nuk u ka dhënë pothuajse asnjë kredi, pra rritja e kredisë është *flat*, nga se ka ardhur shtimi i kapitalit? Nga se ka ardhur kapitali fiks bruto? Ka ardhur nga alokimi i fitimeve. Është kaq e thjeshtë, ka qenë *shareholding*. Kjo është shumë e thjeshtë, shumë teknike dhe shumë financiare. Duke bërë këtë, jemi të bindur, sepse është logjikë e provuar edhe në eksperiencë, që lirimi i fitimeve të kapitalizuara për ta shmangur, që në shumicën e rasteve mund të jenë edhe inaktive, sigurisht që do të lirojnë ide të tjera sipërmarrjeje ose do të kalojnë në konsum, mundësisht në të gjitha fushat, që nga ndërtimi, automobilat, veshjet, pushimet, shkollat, spitalet. Është gjëja më normale në logjikën e lirimit të kapitaleve, se janë kapitale

rezervë, të painvestuara, që do të thotë se kanë një mundësi të dalin nga bilancet dhe të rialokohen në konsum ose në bilance të tjera, në ide të tjera inovative, që mund të kenë, le të themi, përfaqësuesit e kapitalit. Kështu që për këtë element dhe për këtë koncept besoj se të gjithë biem dakord në parim. Sa do të jetë?! Nuk mund ta përlllogarisim sot, sepse pastaj do të ishim në mendjen e çdo sipërmarrësi, por ne u referohemi praktikave dhe rezultateve normale të njohura.

Erion Braçe - Faleminderit!

Me një rezervë që nuk biem të gjithë dakord.

Pyetja e katërt: në relacionin që shoqëron projektligjin ju thoni: “Aktualisht norma e tatimit mbi dividendin është 15%. Kjo e kombinuar me normën e tatimit mbi fitimin korporativ prodhon një ngarkesë fiskale 27,75% për investitorët. Ndryshimi i propozuar ul ngarkesën fiskale për investitorët me 21,8%, ky nivel i krahasueshëm me tatimin efektiv të pagave të larta”. Çfarë keni dashur të thoni me këtë?!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kam përshtypjen se bëhet fjalë për dy natyra të ndryshme të ardhurash: bëhet fjalë për të ardhurat nga puna dhe për të ardhurat nga kapitali, apo jo?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, a mund të krahasohen këto? Këtë keni dashur të thoni?

Faleminderit!

Arben Ahmetaj – Patjetër që po, sepse në final: çdolloj trupe, duke përfshirë edhe këtë komision, që bën politikat fiskale, tenton të balancojë në bazë të ideologjisë fiskale dhe financiare që ka. Jemi duke folur për taksën efektive nga 27,75%, që i shkonte kapitalit, dhe ne jemi të gjithë këtu, pa përjashtim, në promovim të kapitalit fiks bruto, pra të formimit të kapitalit fiks bruto. Ne besojmë se aty fillon të balancohet, në mënyrë që të shmangim edhe debatin që është legjitim.

Si taksohet puna dhe si taksohet kapitali? Te puna duhet të jemi të vëmendshëm, prandaj e solla atë tabelë, që do ta ndaj me ju, se si fillon dhe ndahet puna. Pra, nga 1,9% shkon tek efektivja 21%, dhe 21% maksimumi janë 3% e të punësuarve në Republikën e Shqipërisë. Pra, diferenca e taksimit të punës dhe e kapitalit është shumë e dukshme. Në qoftë se kapitali është 15+8, tek efektivja shkon afërsisht 21,7%. Këtu kapitalin po t’jua ndaj me grupe tek 97% e të

punësuarve janë nën 10,42%, pra puna taksohet në 97% e të punësuarve në 10,42%, kjo është e vërteta statistikore. Kapitali është 15+8.

Erion Braçe – Meqenëse jemi te tabela e të ardhurave nga puna, a mund të më thoni sa rroga janë në fashën nga 300 mijë lekë të vjetër, siç ju referuat, deri në 400 mijë lekë të vjetër? Cila është vlera e këtyre rrogave?

Arben Ahmetaj – Në nivelin 220 mijë janë...

Erion Braçe - Po pyes për rrogat 300-400 mijë lekë të vjetër.

Arben Ahmetaj – Preferoj që të jap një përgjigje të zgjeruar.

Erion Braçe - Më fal, por nuk është pyetja ime. Unë po pyes për rroga nga 30-40 mijë lekë të rinj. Sa rroga janë sot të regjistruara në bordorotë e administratës fiskale dhe sa është fondi i pagave që paguhen për to? Kaq dua.

Arben Ahmetaj – Paga minimale janë rreth 140 mijë, paga minimale me 300 mijë lekë të vjetër, janë 211 mijë, dhe nga 300-400 mijë janë 70 mijë. Pra, i bie afërsisht rreth 400 mijë të punësuar në këtë marzh.

Erion Braçe - Jo, në këtë marzh që pyeta unë janë vetëm 70 mijë të punësuar, jo 400 mijë.

Arben Ahmetaj – Po, por pastaj fillon taksimi midis 300 dhe 400...

Erion Braçe - Që?!

Arben Ahmetaj - Këta të tjerat nuk paguajnë, nuk janë ...

Erion Braçe - Kush? E kam pyetjen shumë të thjeshtë: sa janë rroga nga 300 - 400 mijë lekë të vjetër?

Arben Ahmetaj - Dhe unë iu përgjigja.

Erion Braçe – Sa është fondi i pagave për këto?

Arben Ahmetaj - Për fondin e pagave nuk jam përgatitur ta jap tani, sepse duhet që ta nxjerr nga sistemi i fiskut.

Erion Braçe – Faleminderit!

Dua të di: me rritjen e re të pagave që qeveria ka planifikuar në buxhet për këtë vit, jo gjatë këtyre viteve, sa rroga do të bien në fashën nga 300 -400 mijë lekë?

Arben Ahmetaj – Në publik?!

Erion Braçe – Po, në publik.

Arben Ahmetaj - Besoj se në publik do të jenë afërsisht 16 mijë, sepse këta u prekën, megjithatë numrin e saktë do t'jua japim po sot, por rreth 16 mijë.

Erion Braçe - Po flas për paga që deri në këtë moment nuk paguanin tatim dhe që duke kaluar me rritjen e pagave në këtë fashë...

Arben Ahmetaj – Jo, nuk ishte kjo përgjigja ime. Ju më thatë: “Sa kalojnë nga të pataksuar në të taksuar?”

Erion Braçe – Natyrisht për këtë pyeta, sepse fasha nga 300 deri në 400 mijë lekë të vjetër është e taksuar, apo jo?

Arben Ahmetaj – Po, patjetër.

Erion Braçe – Tani, me rritjen e rrogave të paktën në sektorin publik, sa nga ato rroga që deri dje nuk paguanin tatim sot bien në këtë fashë?

Arben Ahmetaj – Asnjë.

Erion Braçe – Zero!

Faleminderit!

Arben Ahmetaj – Sepse nuk ka në sektorin publik. Ju e dini, është 38 mijë lekë rroga minimale në sektorin publik, që merr një sanitar ose një sanitare.

Erion Braçe – Meqenëse e zgjatet përgjigjen, dua t'ju pyes po në vitin 2013, a kishte rroga në këtë fashë, apo jo?

Arben Ahmetaj – Patjetër që kishte.

Erion Braçe – Faleminderit!

A ka pyetje të tjera. Nuk ka.

Diskutime?

Urdhëroni, zonja Gjylameti!

Blerina Gjylameti – Faleminderit, zoti kryetar!

Duke marr shkas nga përgjigjet që dha ministri, në bazë të propozimeve që kemi bërë, së pari, besoj se kemi një keqkuptim për sa i përket propozimit për uljen e dividendit apo tatimit mbi dividendin në zero për atë çfarë investohet. Fjala është jo për të ulur, për çfarë nuk është shpërndarë, por për atë që do të riinvestohet. Ky ka qenë edhe një nga angazhimet që ne kemi pasur, me qëllim që një pjesë e mirë e fitimit që gjenerojnë kompanitë të riinvestohet për të pasur rritje ekonomike. Kështu që besoj se kemi pasur një keqkuptim.

Arben Ahmetaj – Në qoftë se ju ishit duke folur për dividendin, jemi duke folur për dividendin. Dividendi është e ardhura e kapitalit.

Erion Braçe – Zoti Ministër, mos ndërhyini, të mbarojë zonja fjalën dhe merreni juve!

Blerina Gjylameti – Propozimi ynë ishte që të bëhej zero për të gjithë dividendin, i cili riinvestohet në kompani. Pra, jo për atë që shpërndahet ta ulim tatimin, por për atë që riinvestohet. Gjithsesi kur të bëjmë diskutimin nen për nen, ne mund të ulemi, sikundër edhe ju thatë, teknikisht të shikojmë se si ky propozim mund të bëhet realitet apo jo.

Për sa i përket pjesës së përgjithshme, unë vlerësoj maksimalisht të gjithë punën e bërë për të pasur një lehtësi dhe jo vetëm te pjesa e dividendit, por, mbi të gjitha, te pjesa e pagave. Unë i vlerësoj të gjitha nismat që janë ndërmarrë nga qeveria ndër vite për të arritur, të jemi në linjë me atë çfarë kemi premtuar dhe kemi pasur në programin tonë qeverisës, pra pjesën e taksimit të ndershëm: kush fiton më pak, paguan më pak, kush fiton më shumë, paguan më shumë. Në këtë linjë mendoj se duke vlerësuar përsëris se çfarë është bërë në këto 5 vjet, ju thatë: “Ka qenë 120 milionë efekti në buxhet për uljen apo ndryshimin e progresivitetit në tatimin mbi të ardhurat, duke lehtësuar në mënyrë të posaçme ata që fitojnë më pak”. Egzaktësisht mendoj se në linjë me çfarë është bërë për rritjen e këtyre pagave të ulëta ne duhet ta rishikojmë këtë, për faktin se duke qenë se ne kemi rritur pagat, shpesh një pjesë e mirë, edhe nga shifrat që ju dhatë, kalojnë te fasha e atyre që fillojnë të paguajnë tatim mbi të ardhurat. Kështu që, meqenëse edhe totali i punonjësve, të cilët kanë një pagë nga 30-40 mijë lekë të rinj nuk është aq i konsiderueshëm, pasi po të shikojmë efektin e atyre nga 130 mijë në 150 mijë të rinj, është më tepër se sa mund të jetë ky, mendoj se duhet ta shikojmë. Unë jam e bindur se duke u ulur teknikisht të dyja palët, si pjesa jonë dhe si pjesa juaj...

Arben Ahmetaj – Zonjë, cili është propozimi juaj?

Erion Braçe – Zoti Ministër, mos ndërhyini, ta mbarojë zonja, dhe pastaj mund të sqaroheni deri në fund.

Arben Ahmetaj – Dua të përsërisë propozimin, sepse nuk e dëgjova.

Blerina Gjylameti – Për të qenë më e qartë, sepse kemi kakofoni kur ndërhyjmë dhe nuk arrijmë të dot të shprehemi më qartë me njëri-tjetrin. Duke vlerësuar atë çfarë ju keni bërë dhe ne kemi bërë si maxhorancë, pra pjesën në linjë me progresivitetin, kush fiton më pak, paguan më pak; duke vlerësuar edhe rritjen e vazhdueshme të pagave të atyre që kanë marrë më pak deri tani; duke marrë parasysh faktin se rritjet kanë prekur fashën, e cila nuk paguan dhe kanë kaluar

në fashë që paguan, ne duhet ta rishikojmë këtë, duke propozuar se fasha për të cilën fillon tatimi mbi të ardhurat të jetë 40 mijë lekë të rinj dhe jo 30 mijë lekë rinj, sikundër e kemi. Në momentet që ne kemi marrë këtë lloj angazhimi, edhe të fashave të pagave, kemi qenë në një tjetër situatë, shumë të ndryshme nga kjo që jemi sot. Konkretisht, mendoj se duhet të ulemi edhe një herë dhe t'i të shikojmë fashat e pagave, për të parë sa është e mundshme kjo që propozojmë dhe sa ndikon tek të gjithë ata që kanë paga të tilla qoftë në sektorin privat, qoftë në sektorin publik.

Për sa i përket pjesës së tatimit mbi fitimin, mbi të ardhurat bruto të lojërave të fatit, përsëri mendoj se ka hapësira për t'u ulur dhe për të diskutuar në mënyrë që edhe kjo të jetë në linjë me atë çfarë janë angazhimet tona. Pikërisht edhe ky të jetë një sektor, që ka një tatim mbi të ardhurat, sikundër është edhe në rajon. Ju përmendët disa shifra, i kemi përmendur edhe herën tjetër kur kemi diskutuar në komision shifra të tjera të rajonit dhe më gjerë, kështu që mendoj se duhet t'i shikojmë konkretisht dhe duhet të merren parasysh propozimet që kemi bërë.

Faleminderit!

Arben Ahmetaj – Zonja Gjylameti, një sqarim: në momentin që prek dyshtimin apo tavanin, pra në rastin konkret dyshtimin, nga 300 në 400, i ke dhënë vetes dhe mua lehtësi fiskale, dhe këtë nuk duhet ta bësh. Domethënë, janë 9,6 miliardë, sepse ajo fashë është në progresivitet me të gjithë nivelin e pagave dhe efekti është 9,6 miliardë. Duhet ta dini se 300-shi në këndvështrimin tim personal e kemi të ekzagjeruar, duhet të mendonim që ta ulnim, por nuk është ky momenti dhe diskutimi sot. Po ju them zyrtarisht, por edhe si pjesë e juaja, unë jam absolutisht kundër që të shikohet dyshtimi, pastaj parlamenti le të vendosë si të dojë, është gabim fiskal. Domethënë, propozimin tuaj nuk duhet as ta diskutojmë teknikisht, sepse parimisht është i gabuar. Në qoftë se ju doni, në të drejtën tuaj legjitime, kush fiton më pak, do të paguajë më pak, edhe ky që fiton më pak, paguan 1,9% sot, që këtë fashë ta nxjerrim fare, ne 9,6 miliardë nga buxheti i shtetit i fshijmë, ku përfitojmë unë dhe ti. Jo, nuk duhet. Meqenëse jemi të gjithë me flamurin e progresivitetit, kjo për mendimin tim e rrëzon progresivitetin në themel. Progresiviteti tashmë është i ndërtuar në mënyrë të konsoliduar brenda përshkallëzimit.

Për dividendin po shprehem parimisht, se është vendi i duhur për t'u shprehur. Nuk mund ta bëjmë zero disidentin për ato që janë riinvestuar, nuk ka dividend, ndërsa për ato që dalin jashtë bilancit, nuk besoj se ka një logjikë në këndvështrimin tim, teknike që i nxori paratë jashtë bilancit dhe më pas kur ta verifikoj ai riinveston, që është një instrument i '94 dhe ka dështuar, ta ndjek dhe ta bëj zero. Çfarë t'i bëj zero?!

Domethënë, nga ana teknike ajo që është riinvestuar, ajo është materializuar në bilanc dhe në aset, ndërsa ajo që është mbajtur si rezervë, pra që është shmangur 15% nuk është paguar, është akumuluar ajo ka sens që t'i bësh një amnisti në retrospektivë, jo amnisti evazioni, e theksoj, sepse media e ka qejf më pas që të luajë me fjalën, por t'i lejojë që ato të akumuluar dhe inaktive t'i bëjë të mundur, që kapitali t'i riinvestojë ose të zgjerojë konsumin.

Së treti, do të ulemi teknikisht për propozimin e 30%-shit të GGR, ta diskutojmë, të shikojmë ngarkesat fiskale se si i kemi në rajon, çfarë duam të bëjmë me atë incentivë, si është praktika ndërkombëtare më e mirë. Patjetër, e diskutojmë dhe e vendosim për t'ia propozuar më pas seancës.

Erion Braçe – Kam dy gjëra, para se ta marrë fjalën zonja Gjylameti.

Së pari, dua të them se propozimi që ju keni sjellë është favor fiskal për mua dhe për ju, por, natyrisht, është një favor fiskal minimal në raport me favorin fiskal që u bëhet kompanive që kanë akumuluar 393 miliardë lekë fitime të pandara.

Së dyti, zonja Gjylameti, me çfarë dëgjova unë, për të qenë korrekt dhe për të qenë të ndershëm, propozoi, duke e diskutuar edhe me ne, jo në tagrin e saj personal, por si relatore, duke diskutuar me komisionin, zero për qind tatim mbi dividendin që investohet tani, jo për atë që është trupëzuar, siç thonin juve, por për atë që do të investohet. Ky ishte propozimi që bëri zonja Gjylameti, nuk ishte propozim, që kishte të bënte me atë që është trupëzuar gjatë vitit që shkoi.

Arben Ahmetaj – Ai dividend që është investuar ose do të investohet, ai nuk del nga bilanci, nuk transferohet në të ardhur për kapitalin, për kapitalistin, ai rri brenda bilancit, ai formatohet në investim ose formatohet në formë të tjera, trupëzohet, por në investim në finale.

Erion Braçe - Që të qartësohemi, sepse ju i dhatë numrat: 393 miliardë lekë të cilave ju i referuat si fitim i realizuar, janë investuar, apo jo?

Arben Ahmetaj – Ajo që është investuar, nuk është më e akumuluar.

Erion Braçe - Jo, ky 393-miliardëshi që ju thatë?

Arben Ahmetaj – Më fal, diku mund të jetë investuar. Ajo është bilanc pas bilanci.

Erion Braçe - Faleminderit!

Arben Ahmetaj – Ajo që është investuar, nuk formatohet në dividend, sigurisht, ajo nuk del fare nga bilanci.

Blerina Gjylamenti – Besoj se ka një keqkuptim me mënyrës se si po shprehemi të dyja palët. Në qoftë se ne themi se kemi fitim të akumuluar, të pashpërndarë, propozimi që ne kemi është pikërisht mbi këtë, nëse kompania do që të ketë lehtësi fiskale nga 15%, në 8%, që ju keni propozuar, ne propozojmë që të zbresim në zero dhe në fund, për çdo lekë që ata nuk kanë shpërndarë, por që mund ta investojnë. Kjo është ideja për të nxitur investimet në ekonomi.

Së dyti, unë besoj se lehtësirat fiskale nuk ia bëjmë vetvetes te 30-40 mijë-lekëshi. Unë jam deputete e Kuvendit të Shqipërisë dhe paga ime nuk është 30-40 mijë lekë, nuk hyj në këtë fashë, por në fashat e larta, ku të gjithë ne kemi vendosur me unanimitet, si forcë politike, që të gjithë ata që kanë paga më të larta duhet të paguajnë më shumë.

Propozimet që kanë ardhur zgjidhin një nga kërkesa e vazhdueshme që kemi pasur për të rishikuar pagat nga 130 mijë lekë në 150 mijë lekë, tani sugjerimi ynë lidhet angazhimin që të gjithë kemi marrë, për pagat nga 30-40 mijë lekë, ku futen infermierët, mësuesit, punonjësit e pastrimit dhe policët, të cilët kanë pasur një rrogë të ulët dhe ne ndër vite e kemi rritur. Flas për këtë shtresë, nuk flas për politikanët. Megjithatë, unë sugjeroj që ne duhet të shikojmë konkretisht. Ju thoni që totali është 9,6 miliardë dhe ne, kur kemi ndërmarrë këtë nismë, e cila ka qenë pjesë e programit tonë qeverisës të vitit 2013, kemi pasur parasysh një tjetër situatë dhe jo këtë që kemi sot dhe, duke parë këto ndryshime, unë mendoj që duhet t'i rishikojmë.

Tani, nëse ne jemi në momentin e duhur që mund të rishikojmë të gjitha fashat dhe ju me të drejtë mund ta ngrini këtë pyetje, sepse duke ngritur dyshe-menë, ne mund të ngremë të gjithë fashat, është diçka që duhet ta shikojmë së bashku dhe të ulemi konkretisht. Megjithatë, mendoj se duhet të jemi të hapur dhe të ulemi të shohim ndryshimet që mund të bëjmë. Rritja nuk mund të jetë patjetër 40 mijë, mund të jetë edhe 35 mijë ose 37 mijë dhe kjo varet nga mundësitë që kemi, por mendoj se duhet të ulemi konkretisht që ta shikojmë.

Arben Ahmetaj – Zonja Gjylameti, edhe ju paguani për fashën 300-400 mijë lekë të vjetër, edhe unë paguaj, nuk paguan vetëm infermieri.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nëse e dini, patjetër e dini, atëherë si mund të më thoni që ne nuk përfitojmë. Po, përfitojmë, prandaj është ndërtuar progresiviteti i fashave, në mënyrë që ai që është midis 300-ës dhe 400-ës të përfitojë më shumë, por edhe ti dhe unë, që jemi te 127-shi, përfitojmë nga ajo lehtësi, sepse ajo fashë, që është ekskluzivisht brenda 300-400-ës e ka përfituar progresivitetin në 2%. Ti dhe unë, më fal që të drejtohem kështu, por vetëm për ilustrim, po të hiqet fasha nga 300-

400, që parimisht është e gabuar, por po i referohemi për një sekondë, i bie që ne të përfitojmë. Jo, ne nuk duhet të përfitojmë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Për çfarë duhet ta rishikojmë, sepse nuk e kuptova. Më thatë që të rrisim fashën nga 300 në 400, që parimisht është e gabuar, sepse dëmton progresivitetin dhe integritetin fiskal të punësimit, por për një sekondë harroje parimin që po them unë, ditën që ne përjashtojmë fashën 300 në 400 të vjetra përfitojmë të gjithë ne dhe nuk duhet të përfitojmë. Ata që kanë pagat e ulëta kanë përfituar, sepse taksohen me 1,9% në këtë fashë, ndërkohë, pagat janë duke u rritur dhe progresiviteti qëndron. Ne jemi të hapur, sepse na detyron procedura dhe duhet ta nisim nga parimet.

Lidhur me elementin e dividendit, unë mund t'jua sqaroj edhe teknikisht. Ai dividend, që është kapitalizuar apo investuar është i pashpërndarshëm, ndërsa ai që është formatuar si rezervë, do të shpërndahet.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, ai që nuk është shpërndarë dhe është fitim i akumuluar mund të jetë trupëzuar në investim, pjesa tjetër është rezervë. Ne po flasim për rezervën, që do ta nxjerrin nga bilanci, atë që është e shpërndarshme, e cila ka mundësi të dalë nga bilanci, ndërsa ajo që ka qenë brenda bilancit, është transferuar nga fitim dhe është kthyer në aset, e ka zero taksimin dhe është e pashpërndarshme nga ana teknike.

Erion Braçe – A ka diskutime të tjera? Jo.

Atëherë, në cilësinë e deputetit edhe unë kam disa gjëra për të thënë.

Para katër vjetëve, edhe si maxhorancë e dalë nga zgjedhjet e vitit 2013, vendosëm parimin e progresivitetit në tatimin e të ardhurave, kryesisht të të ardhurave nga puna, sepse të ardhurat e tjera, edhe siç vërtetohet sot lehtësisht, janë pothuajse në kufijtë e një tatimi të sheshtë, pavarësisht se janë rritur. Kurrë nuk kemi thënë se shkallët e progresivitetit janë të vendosura njëherë e përgjithmonë dhe ndryshimi që ju sillni sot pa dyshim e vërteton këtë. Pra, parimi nuk preket, është progresiviteti, ndërkohë që shkallët e progresivitetit, në tatimin mbi të ardhurat nga puna, ndryshojnë. Ju po i ndryshoni të ardhurat nga puna në fashën nga 130 mijë lekë deri në 150 mijë lekë. Për të qenë të ndershëm deri në fund, ky është një favor fiskal, ku përfshihemi edhe ne. Ky favor fiskal, ku përfshihemi edhe ne, nuk vjen duke ndryshuar fashën nga 300 në 400, por vetëm nga kjo që ju keni sjellë. Duke përfshirë edhe dividendin vjen një tjetër favor fiskal, ku

përfshihet edhe një kategori deputetësh, përfshirë edhe ata që nuk vijnë fare në parlament, por rrinë atje dhe numërojnë paratë nga mëngjesi deri në darkë. Janë disa që rrinë atje dhe numërojnë deri në 10 milionë euro në vit fitime, jo nga rroga e Kuvendit, që nuk vijnë asnjëherë, por nga të ardhurat e bizneseve të tyre, me të cilat merren. Thënë këtë, natyrisht që dëgjova me shqetësim prandaj ndërhyra, nuk bie fare dakord që të ardhurat nga kapitali me të ardhurat nga puna mund të jenë të krahasueshme. Nuk ndodh kurrë që norma e të ardhurave nga kapitali, norma e rritjes, me normën e rritjes së të ardhurave nga puna të barazohen ndonjë ditë, përveç rasteve kur ka evazion fiskal ose në rastet kur për t'iu shmangur normave të tjera detyrohen për t'u kategorizuar si të ardhura nga puna, ku ju i përmendet disa nga këto raste. Po e përsëris, nuk ndodh kurrë që norma e rritjes së të ardhurave nga kapitali të jetë e barabartë me normën e rritjes së të ardhurave nga puna. Pikërisht për këtë arsyes iu referova relacionit, sepse m'u duk i paarsyeshëm krahasimi midis normës efektive të tatimit mbi fitimin dhe dividendin me normën efektive të tatimit mbi të ardhurat nga puna apo mbi rrogat.

Ndërkohë, në krahun tjetër unë mendoj se ligji për tatimin mbi të ardhurat, që kemi përpara, është i vjetër. Ne duhet ta kishim shikuar me kohë, madje kemi diskutuar edhe në këtë komision për një ligj të ri për tatimin mbi të ardhurat, i cili integron të gjitha të ardhurat e individit dhe i taton në shkallë progresive.

Në këtë pikë më lejoni që edhe unë t'u referohem disa shifrave. Ju thatë që nuk ka asnjë vend në botë që mbron pagat deri në 300 mijë lekë. Natyrisht që për një vend si Shqipëria, ku të ardhurat e vetme janë të ardhurat nga puna, kjo merr një vlerë dhe, pikërisht për këtë arsye është vendosur fasha deri në 30 mijë lekë, sepse ka pasur edhe propozime të tjera. Këtu kishte nga ata që thoshin që ta hiqnim fashën fare, pastaj kur u ndjenë nën presion elektoral, politik e të tjera me radhë thanë që ta bëjmë deri në 100 mijë lekë të vjetër. Prandaj diferenca midis nesh dhe atyre, të cilët nuk vijnë këtu, është tek të ardhurat minimale nga puna, të ardhurat e punëtorëve.

Më lejoni t'ju them se Austria deri në 11 milionë euro të ardhura në vit nuk i takson dhe taksën e ka zero.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

A mund ta mbaroj unë? Portugalia deri në 7091 euro të ardhura vjetore e ka zero tatimin, Gjermania deri në 9 mijë euro taton me zero, Holanda deri 19882 euro i takson me zero, Franca deri në 5963 euro të ardhura vjetore i takson me zero, Finlanda deri në 13 mijë euro, Spanja deri në 5150 euro i taton me zero. Pa diskutim që këtu ka të bëjë edhe ajo që ju thoni, niveli i të

ardhurave për frymë të këtyre shteteve, por pikërisht kësaj iu referova, kur e ardhura e një individi në Shqipëri nuk i arrin 3 mijë euro në vit, për këto paga që po flasim, për pagat e ulëta të punëtorëve, pa diskutim që ky debat është legjitim. Edhe propozimi i zonjës është legjitim, ashtu siç është legjitim edhe propozimi për të ndryshuar këtë ligj dhe për të integruar të gjitha të ardhurat në një deklaratë të të ardhurave vjetore dhe t'ia nënshtrojmë tatimit progresiv sipas shkallëve që ju mendoni dhe ne vendosim. Të gjitha këto janë legjitime.

Në krahun tjetër, duhet të fillojmë të mendojmë edhe për një gjë, që për mua individualisht është thelbësore, për pabarazinë, sepse ndodh që favore fiskale të ndikojnë edhe drejtpërdrejt në këtë pikë të rëndësishme, siç është pabarazia dhe për këtë duhet të mendojmë të gjithë. Nuk iu referova kot njerëzve të këtij Kuvendi, që përfitojnë në ato përmasa, siç referoj për deputetë këtu, që të ardhurat e vetme i kanë nga puna në Kuvend, zero, asgjë tjetër, ashtu edhe për njerëz jashtë kësaj sale që të ardhurën e kanë nga puna që bëjnë, ku diferenca është shumë e madhe. Pa asnjë lloj diskutimi që propozimi im është një ligj i ri për tatimin mbi të ardhurat, i cili sanksionon edhe më fort progresivitetin në të ardhurat e një individi në harkun e një viti fiskal, por në këtë moment që ndodhemi unë e gjej legjitim propozimin e zonjës Gjylameti, në konsultim edhe me kolegët, për të parë një shkallë të re të progresivitetit të të ardhurave nga puna. Faleminderit!

Arben Ahmetaj – Ligji i ri për të ardhurat, besoj unë, do të avancojë së punuari me Fondin Monetar Ndërkombëtar me asistencë teknike gjatë 6-mujorit të parë të vitit 2019, por dua t'ju sqaroj që duhet t'i ndani të ardhurat nga të ardhurat nga puna. Ato që u referuan janë të ardhura dhe jo të ardhura nga puna. Është legjitime të bëni propozime, sepse në fund parlamenti është ai që aprovon buxhetin dhe paketën fiskale, por unë personalisht jam shumë kundër zgjerimit të fashës, progresiviteti sot është serioz, është në favor të qytetarëve, në favor të të punësuarve dhe në favor të pagave të ulëta. Zgjerimi i fashës përjashtuese shkatërron sistemin e të ardhurave personale, e shkatërron në shifra dhe në parim. Prandaj është shumë e rëndësishme që këtu të diskutohet për të ardhura nga puna dhe të ardhura, sepse edhe ne të ardhurat deri në 5 milionë i kemi zero për biznesin e vogël, deri në 14 milionë 5%. Ne jemi një vend i varfër, nuk jemi as si Austria, as si Sllovenia, as si Finlanda dhe as si Franca, por jemi një vend që kemi nevojë të bëjmë investime dhe të kemi paketa sociale.

Për hir të rekordeve, unë solla taksimin e punës, i cili nuk është i barabartë me taksimin e kapitalit, ai është i dallueshëm parimisht dhe nominalisht. Ja ku është taksimi i punës dhe parimi

që kemi ne: “Kush fiton më shumë, paguan më shumë”. Në qoftë se ju iu referuat ngritjes së nivelit nga 1300 në 1500, është reflektimi i asaj që ju kërkuat në këtë komision, ku thatë se klasa e mesme është zgjeruar. Meqenëse klasa e mesme është zgjeruar për shkak të rritjes së pagave dhe punësimit, për shkak të përmirësimit të tregut të punës dhe të rritjes ekonomike ne bëmë atë që bëmë, që nga 1300 e çojmë në 1500 dhe përfitojnë 15400 përfitues të klasës së mesme, siç iu referuat ju. Kjo është e kujdesshme si masë fiskale qoftë në parim, qoftë në shumë, 3 milionë. 3 milionë atje, 9 milionë këtu, 5 milionë atje, 10 milionë këtu, kaq është konsolidimi fiskal.

Po të flasim për parimet për të varfrit dhe pabarazinë, unë jam një ndër të parët që kam votuar për progresivitetin dhe kjo më bën krenar, por ka dy anë peshoreje, njëra është paketa fiskale dhe paketa sociale, që prekin të dyja anët e buxhetit dhe ana tjetër është borxhi publik, i cili e shkatërron këtë vend dhe nuk e lë të ngrihet nga toka. Unë nuk dua të bëj debat për këtë, sepse jemi 100% dakord. Faleminderit!

Erion Braçe – Kërkoj ndjesë që po e vijoj këtë histori, nuk do të kisha folur nëse nuk do ta vijonit edhe ju, por, me thënë të drejtën, unë kur jam këtu nuk spekuloj, as kur nuk jam këtu, them atë që mendoj dhe u referohem të vërtetave. Në asnjë moment nuk thashë që këto janë të ardhurat nga puna, përkundrazi, unë thashë që në këtë vend ata që kanë rroga 300-400 mijë lekë, të vetmen të ardhur kanë këtë. Pra, siç janë këto të ardhura, duke përfshirë të ardhurat nga interesat, nga qiratë, nga dividendi e të tjerë, përfshirë edhe të ardhurat nga puna, këta njerëz që sot paguhën 300-400 mijë lekë në këtë vend i kanë të ardhurat e vetme, nuk kanë të ardhura as nga interesat, as nga qiratë, por janë infermierë, edukatorë, mësues të ciklit fillor që të vetmen të ardhur kanë këtë. Pra, ajo që ju thoni, në gjykimin tim, është pothuajse e barabartë me këtë. Në qoftë se këta kanë këto të ardhura, ne kërkojmë që deri në këtë nivel të përjashtohen nga pagimi i tatimit.

Së dyti, në qoftë se këtij vendi i ka ardhur e keqja nga rritja e borxhit, rritja e deficitit dhe nga tatimi i të ardhurave nga puna, atëherë unë dorëzohem, por deri sot as ju, as unë dhe as të tjerët nuk bindemi dot që këtij vendi i ka ardhur problemi nga deficitin dhe nga tatimi mbi të ardhurat nga puna. Jo, i ka ardhur nga tatimi mbi fitimin.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

A ka mundësi ta mbaroj unë?

Po ju korrigjoj: nga përgjegjshmëria në shpenzimet e pambuluara, që të jemi më të qartë deri në fund fare.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, pra, por edhe ai ekspansion i papërgjegjshëm, se edhe ai i pambuluar ishte, por po flasim për të ardhurat. Kur të vijmë te shpenzimet, flasim edhe për to.

Po them edhe një herë tjetër mendimin tim modest: nuk besoj se këtij vendi i ka ardhur e keqja nga tatimi mbi të ardhurat nga pagat. Jo, nuk e mendoj fare këtë gjë dhe do të vijoj të mos e mendoj këtë gjë, pavarësisht mendimeve të ndryshme që kemi.

Së fundi, më lejoni t'ju them se shqetësimi për deficitin dhe për borxhin natyrisht që është edhe shqetësimi ynë. Këtë pjesë as nuk e diskutoj. Pikërisht për këtë arsye, edhe siç e vërejtët edhe ju, nuk pati asnjë diskutim për masat e tjera që ju keni marrë, të cilat janë për t'u vlerësuar, për t'u mbështetur që të mos lejojmë atë që thoni ju: bjerren e bazës së taksueshme në këtë vend, duke u shmangur për të çuar para, dhe për t'iu shpëtuar tatimeve këtu, në parajsa fiskale. Patjetër, kjo gjë mbështetet, ashtu siç mbështetet edhe pjesa që keni definuar në mënyrë të qartë, e cila ka të bëjë me pasuritë kombëtare të këtij vendi në tokë dhe në det. Pa asnjë lloj diskutim që këtë e mbështesim deri në fund, por në krahun tjetër i gjithë ky diskutim erdhi, sepse brenda një ligji kemi edhe favorin fiskal për dividendin, edhe tatimin mbi të ardhurat nga pagat. Për këtë arsye iu referova edhe çështjes së pabarazisë, sepse e gjithë bota po lëviz në këtë sens, duke e adresuar këtë problematikë që vjen edhe nga pikëpamja fiskale, akumulohet te pabarazia. Kjo është arsyeja. Nuk ka asnjë arsye tjetër.

Arben Ahmetaj – E para dhe mbi të gjitha, papërgjegjshmëria fiskale sjell rritje borxhi dhe papërgjegjshmëria fiskale është në të dyja krahët, siç e kemi parë në qeverisjen e Salitu, i cili i bëri çorap të ardhurat dhe shpenzimet. Ato nuk diskutohen veç e veç, por bashkë. Janë instrumente të integruara të konsolidimit fiskal. Çdo përjashtim joracional sjell papërgjegjshmëri fiskale tek të ardhurat. Çdo ekspandim joracional dhe i pabalancuar te shpenzimet sjell iracionalitet dhe papërgjegjshmëri fiskale, të cilat të gjitha përsëri bihen mbi qytetarin nëpërmjet deficitit të borxhit dhe kaskadimit të efekteve direkte dhe indirekte. Ka një koeficient që e mat pabarazinë, që është koeficienti Gini, të cilin e ka shpikur bota dhe nuk ka nevojë ta shpikim as unë e as ti. Koeficienti Gini mat pabarazinë ose ngushtimin e pabarazisë. Fatmirësisht, në këtë vend është përmirësuar. Pse është përmirësuar? Sepse janë krijuar 234 mijë vende të reja pune dhe konsumi ka 13 tremujorë që vetëm rritet. Nuk është përjashtimi tatimor instrumenti më eficient, aq më tepër që ne këtu kemi diferencë të madhe të taksimit të punës dhe të kapitalit.

97% e të punësuarve e kanë, tani bashkë me 15 mijë e 400 shkon në gati 98 mijë të punësuar, e kanë nën 10,42% taksimin e të ardhurave nga puna. Patjetër, ato janë të ardhurat, se ky është sistemi. Kuptohet që në një ditë do të shkojmë tek të ardhurat e integruara dhe do të kuptojmë që edhe ai infermieri mbase ka të ardhura të tjera, përtej të ardhurave nga puna, sepse kjo është ekonomi e tregut dhe mundësitë janë të shumta. Kur t'i kemi të integruara, do të dallojmë pak më mirë se sa ka njëra shtresë dhe sa ka tjetra.

Theksoj përsëri se jam shumë i hapur të diskutojmë 30% për GGR-në për lojërat e fatit. Unë do të qëndroj deri në fund, unë jam një votë, kundër ekspandimit joracional fiskal të zgjerimit të fashës së përjashtuar dhe do të jem deri në fund kundër në parim, por edhe në teknikalitet. Sigurisht, pastaj do të vendosë parlamenti, por unë këtë kam detyrë. Kuptohet që çdo relaksim në njërin anë ka efektet te borxhi dhe te deficitin. Sigurisht që asnjëri nuk bën dot atë që duhet bërë, por duhet një grup i tërë që të ketë qartësisht objektiv konsolidimin fiskal. Konsolidimi fiskal nuk është një shifër, por është një përpjekje e tërë me instrumente poshtë. Të gjithë biem dakord për borxhin dhe deficitin. Po si? Se borxhi dhe deficitin nuk janë shtylla që thejnë gjithçka, por janë konsekuencë e disa veprimeve fiskale dhe financiare.

Erion Braçe –Nuk dua të bëhem i bezdisur dhe as të marr apo të them fjalën e fundit fare. Pa diskutim, Ministër, i ka shpikur bota koeficientet Gini, ashtu siç bota ka shpikur edhe të majtën, edhe të djathtën. Siç janë koeficientet Gini, të cilat me lejoni të them me modesti se nuk tregojnë asnjë gjë, fjala vjen, ç'tregon në kuptim të pabarazisë shifra 0,6%, 0,7%, qoftë edhe 1%? Ka disa tregues të tjerë që e masin pabarazinë në mënyrë të qartë. Natyrisht, janë fashat e atyre që akumulojnë të ardhura në harkun e një viti. Janë, siç i referohet sot e gjithë bota, këta 1% më sipër që akumulojnë para pa fund dhe është kthyer në një shqetësim për FMN-në, së cilës i referoheni ju, për qeveri të ndryshme, për universitetet, për shkencëtarët, siç ka përsëri një fashë të sipërme që shkon deri 20%, që e shoqëron këtë 1% përsëri atje lart, siç ka edhe një fashë nga 30%-40%, e cila u gjet si pjesa e mesme për të luftuar dhe për të korrigjuar në mënyrë të qartë pabarazinë midis këtij 1% dhe 20%, që e shoqëron lart me atë 30%-40% që është poshtë. Në qoftë se ne nuk do të fokusohemi te kjo pjesa e mesme, te kjo pjesa fundore, pa asnjë lloj diskutimi që pabarazia nuk do të ketë të përmbushur ata objektiva që kemi vendosur. Në rast se ne do të vazhdojmë të merremi me numra 0,6, 0,7, 0,5, 1 etj., pa asnjë lloj diskutimi nuk do ta dallojmë pabarazinë dhe do të ndodhë që do të shkojë Kryeministri nga një familje, në një tjetër për ta nxjerrë varfërinë dhe pabarazinë në dritë. Kjo gjë do të ndodhë, siç po ndodh. Pikërisht për

këtë arsye unë mendoj që modestish nuk ju kemi propozuar thjesht përjashtim, por një shkallë të re në progresivitetin që e kemi pranuar të gjithë si parim. Të mos shkojmë drejtpërdrejt te përjashtimi. Jo, një shkallë e re në progresivitetin e të ardhurave nga...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Mirë, ore dakord, ky është mendimi yt, ky është imi, çfarë problemi ka tani? Ju mendoni ashtu, unë mendoj kështu. Ju jeni me koeficientin Gini, unë jam me këto fashat...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ja, ta mbaroj pak! Me durim! Jo, kjo rrëzon relacionin që keni sjellë ju. Nga relaksimi i tatimit nga të ardhurat mbi dividendin pritet të shtohet konsumi dhe këta, që kanë nga tre-katër shtëpi, do t'i shtojnë shtëpitë dhe 12-13 muaj pushime do t'i bëkan më tepër dhe do t'i bëjnë në Shqipëri e jo jashtë vendit. E lëmë këtë histori!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Më fal, fjalët “muhabet koti” merrini mbrapsht! Në qoftë se i kishit kot ato që thatë, pa asnjë lloj problemi se janë tuajat, nuk janë të miat.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Unë po u referohem atyre që the ti. Në qoftë se ti i ke kot ato që thua, atëherë edhe unë kot i kam. Mban përgjegjësi? Edhe unë mbaj edhe më shumë përgjegjësi se ty që ta dish. Natyrisht që kjo është çështja jote. A ka diskutime të tjera lidhur me këtë projektligj? Nuk ka. Atëherë, diskutimi në parim i projektligjit “Për tatimin mbi të ardhurat” mbyllet këtu.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Ekonominë dhe Financat

PROCESVERBAL

Tiranë, më 07.11.2018, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Erion Braçe – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

2. Prezantimi i projektligjit të paketës fiskale “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9975, datë 28.07.2008 “Për taksat kombëtare”, i ndryshuar””

Marrin pjesë:

Erion Braçe, Anastas Angjeli, Evis Kushi, Antoneta Dhima, Blerina Gjylameti, Ilir Xhakolli, Xhavit Bushaj, Arben Pëllumbi, Reme Lala, Ervin Bushati dhe Roland Xhelilaj.

Mungojnë:

Jorida Tabaku, Edmond Spaho, Agron Shehaj, Fatbardha Kadiu, Nadire Meçorapaj, Dashamir Shehi, Edmond Haxhinasto dhe Përparim Spahiu.

Të ftuar:

Arben Ahmetaj - Ministër i Financave dhe Ekonomisë

Nikolla Lera - Drejtor i Përgjithshëm i Politikave Makroekonomike në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Endrit Lami – Drejtor në Drejtorinë e Politikave Makroekonomike në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Enkeleda Kuci -

Arbër Lleshi – Këshilltar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Erion Braçe – Viojmë me projektligjin “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, i ndryshuar.
Fjalën e ka ministri.

(Diskutime pa mikrofon)

Atëherë, vazhdojmë me projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9975, datë 28.07.2008 “Për taksat kombëtare”, i ndryshuar”.

Arben Ahmetaj – Për sa i përket ligjit “Për taksat kombëtare” kemi propozuar uljen e nivelit të taksës me 2/3-at për ambalazhet plastike dhe zgjerimin e bazës së saj me produkte të tjera të plastikës, pra artikuj plastikë që përfshijnë kodin 39 të nomenklaturës së mallrave.

Taksa për ambalazhet e qelqit reduktohet nga 10 lekë për kilogramë në 5 lekë për kilogram, me qëllim uljen e kostove të prodhimit të produkteve vendase. Për prodhimin brenda vendit propozohet vendosja e taksës mbi lëndët primare të importuara që përdoren për prodhimin e mallrave plastike, duke përfshirë ambalazhin, pra taksimin vetëm një herë; rritje e nivelit të rentës minerare për mineralin e kromit që eksportohet nga 6% në 9%; hiqet edhe taksa e karbonit për benzinën dhe gazoilin për eksportin. Këto janë elementet që ne propozojmë për sa u për taksave kombëtare.

Faleminderit!

Erion Braçe – Zonja Gjylameti.

Blerina Gjylameti – Faleminderit, kryetar!

Për sa i përket projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9975, datë 28.07.2008 “Për taksat kombëtare”” ky projektligj ka si qëllim ndërhyrjen në ligjin për “Taksat kombëtare” për të përmirësuar procedurat e mbledhjes së disa prej taksave më kryesore. Konkretisht, projektligji i propozuar nga Këshilli i Ministrave për ndryshimin e legjislacionit të taksave kombëtare përmban dispozitat e mëposhtme:

Në nenet 1, 2, 3, 4 dhe 5 të projektligjit, që ndryshojnë nenet 3, 4, 5, 8 dhe 9 të ligjit aktual propozohet rishikimi i dispozitave që lidhen me taksën e ambalazheve të plastikës dhe të qelqit, duke bërë një kategorizim si të produktit, po ashtu edhe të nivelit të taksës për të evidentuar problematikat e evidentuara nga strukturat e BE-së që lidhen me diferencimin e taksës në import dhe në prodhimin vendas për të përmbushur kërkesat e industrisë vendase të prodhimit ushqimor për kufizimin e konkurrencës së pandershme.

Në vitin 2008, kur u miratua ligji nr. 9975, në kategorinë e taksave kombëtare u përfshi edhe taksa për ambalazhet plastike të lëngjeve, si bidonë, shishe plastike, e kuti të plastifikuara

të të gjitha formave dhe përmasave të mbushura, të prodhuara në vend dhe të importuara për produktet si uji, pije freskuese, lëngje frutash e perimesh, qumështi dhe nënproduktet e tij, vajrat ushqimore, vajrat lubrifikues dhe detergjentet.

Në mesin e vitit 2010 për produktet plastike aplikohet akcizë në masën 1 mijë lekë të vjetër për kilogram plus TVSH-në, më pas me ligjin nr. 83/2012 kjo taksë u ndryshua në taksën e ambalazheve të plastikës dhe qelqit duke saktësuar përkufizimin e taksës, në mënyrë që të mos kishte dallime në llojet e produkteve të ambalazhit që kishte subjekti i taksës, ndërsa niveli i saj u diferencua sipas llojit të ambalazhit. Taksa për ambalazhet plastike për produktet vendase dhe ato të importit u caktua në masën 100 lekë për kilogram. Taksa e ambalazhit të prodhuar nga mbeturinat plastike të riciklueshme të gjeneruara në vend u caktua në masën 50 lekë për kilogram. Taksa për ambalazhet e qelqit për produktet vendase dhe ato të importit u caktua në masën 10 lekë për kilogram.

Në paketën fiskale për vitin 2017 Komisioni për Ekonominë dhe Financat, në kuadër të politikës për stimulimin e industrisë vendase, amendoi ndryshimin e përcaktimeve të bëra në pikën 8 të nenit 4 të ligjit bazë, duke propozuar që taksa për ambalazhet e prodhuara nga riciklimi i mbetjeve në vend nga 50 lekë për kilogram të vendosej në masën simbolike 1 lekë për kilogram.

Në paketën fiskale për vitin e ardhshëm propozohet një rikategorizim i taksës në taksën e materialeve artikujve plastike dhe ambalazheve plastike të importuara, e cila parashikohet të caktohet në masën 35 lekë për kilogram dhe në taksën e lëndëve të para në formën primare të importuar, që përdoret për prodhimin vendas të produkteve të plastikës, e cila parashikohet të caktohet në masën 25 lekë për kilogram. Taksa e ambalazheve prej qelqi e ambalazheve të importuara dhe të prodhuara në vend parashikohet të caktohet në masën 5 lekë për kilogram. Kjo taksë do të zbatohet edhe në rastet kur materiali i qelqit zë të paktën 85 % të masës së përgjithshme të ambalazhit të produkteve të tjera.

Agjentë të ngarkuar për vjeljen e kësaj takse do të jenë përsëri administrata doganore në rastin e importit dhe administrata tatimore në rastet e prodhimit vendas. Komisionet që do të përfitojnë agjentët për mbledhjen e taksës do të jenë përsëri në masën 0 lekë.

Në nenet 2 dhe 6 të projektligjit propozohet rritje e përqindjes së rentës minerare nga 6% në 9% për mineralet e kromit për eksport, pjesë e grupit të parë, minerale metalike të shtojcës nr. 2 të ligjit, si dhe rishikimi i përqindjes së rentës minerare për përmbajtjen e mineralit metalor në

nënproduktin mineralar dhe në rastin e shitjes së mineraleve metalike për përpunim brenda vendit, duke ulur masën nga një e dytë në një të tretën e normës së rentës, duke u mbështetur në nevojën e ndërmarrjes së politikave, të cilat stimulojnë përpunimin e mineraleve në vend, rritjen e vlerës së tij për eksport dhe dekurajimin e eksportit të mineralit të kromit të papërpunuar.

Në pikën 2 të nenit 2 të projektligjit propozohet përjashtimi nga pagesa e taksës së karbonit vetëm për sasitë e benzinës dhe gazoilit që eksportohen, duke unifikuar kështu edhe përjashtimin e këtyre produkteve nga taksa e qarkullimit të bërë në vitin 2016.

Në nenin 5 të projektligjit propozohet të falen të gjitha detyrimet e prapambetura të taksës vjetore të qarkullimit rrugor apo të konfiskuara me vendim të formës së prerë të gjykatës, të cilat i kalojnë në administrim Drejtorisë së Përgjithshme të Rezervave Materiale të Shtetit. Gjithashtu, po në këtë nen propozohet që mjetet e konfiskuara me vendim të formës së prerë të gjykatës, të cilat i kalojnë në administrim Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara apo Drejtorisë së Përgjithshme të Rezervave Materiale të Shtetit për qëllime përdorimi ose rishitje, të jenë të përjashtuara nga pagimi i taksës së përvitshme dhe i regjistrimit të mjeteve luksoze.

Ndryshimet në taksën e ambalazheve plastike dhe të rentës parashikohet të sjellin efekte pozitive me rreth 0,5 miliardë lekë më shumë për vitin 2019.

Duke qenë se projektligji është hartuar në shërbim të interesit publik dhe në përputhje të plotë me politikat e shtetit për grumbullimin e të ardhurave të ligjshme, i propozoj komisionit miratimin e tij me sugjerimin e mëposhtëm: aplikimin e rritjes së rentës minerare, me qëllim shtimin e vlerës së saj dhe, duke pasur parasysh që burimet janë të fundme, kjo politikë të aplikohet jo vetëm për disa produkte, por për të gjithë gamën e produkteve në industrinë nxjerrëse.

Ju faleminderit!

Erion Braçe – A ka pyetje!

Urdhëroni, zoti Pëllumbi!

Arben Pëllumbi – Faleminderit, kryetar!

Unë, personalisht, por besoj të gjithë ne këtu në komision kemi qenë dhe do të vazhdojmë të jemi gjithmonë pro të gjitha masave, të cilat tentojnë të nxisin prodhimin vendas. Për këtë arsye besoj se të gjitha propozimet që ju sillni në lidhje me ambalazhet plastike për të nxitur prodhimin vendas janë të mirëpritura, gjithashtu edhe për ambalazhet e qelqit.

Pyetja ka të bëjë vetëm me faktin, se ndoshta nuk e kuptoj unë mirë, se si e nxitim prodhimin vendas në ambalazhet e qelqit, duke ulur taksën si për importin, ashtu edhe për ambalazhin vendas? E para.

E dyta, në lidhje me rritjen e rentës minerare për mineralet e kromit, për të cilën jam pro, doja të dija a keni një politikë më të zgjeruar fiskale?

Gjithashtu, në lidhje me propozimin që bëri relatorja, për të gjitha pasuritë e këtij vendi, a kemi një perspektivë zhvillimi duke pasur parasysh industrinë e bakrit, ku kemi nevojë të madhe për të rritur vlerën e shtuar brenda vendit, por edhe për nën produkte të tjera?

Faleminderit!

Arben Ahmetaj – Faleminderit!

Është shumë e drejtë ajo që thatë ju sa i përket rentës minerare, por edhe referuar asaj tha zonja Gjylameti. Praktikisht logjika pas rritjes së rentës është një përlllogaritje e rezervës së njohur të komercializuar të kromit. Rezerva e një **ore** e komercializuar e kromit është afërsisht 5 milionë tonë. Nëse do të ecet me atë nivel eksporti që ka sot, që shkon 550 deri në 600 mijë tonë në vit, presupozohet që rezerva e njohur e komercializueshme të mbarojë për 7-8 vjet. Ndryshimi i vlerës së shtuar, të mbetur në vend midis kromit si mineral i papërpunuar dhe ferrokromit të përpunuar, në rastin më të keq kur tregjet bien, shkon 1 me 3 ose 4, në rastin më normal shkon 1 me 5 ose 1 me 6. Për hir të së vërtetës, ka investime serioze si ai i Elbasanit, i financuar nga BERZH-i, për shembull, që ka shkuar mbi 20-25 milionë dollarë investimi i përpunimit. Detyrë e qeverisë është të lehtësojë eksplorimin e mëtejshëm të rezervës së njohur të komercializueshme të kromit.

Sa i përket bakrit, ne do t'ju sjellim statistikën mbi bazën e të cilave mund të reflektojmë përtej asaj që kemi sot.

Sa i përket propozimit të zonjës Gjylameti për pasuritë e tjera tokësore ose nëntokësore të rentuara, unë me kënaqësi do t'ia shtoja naftës bruto rentën për eksport. Ajo që do të diskutojmë këtu është koncepti i marrëveshjeve, sepse në marrëveshjet hidrokarbure ka një klauzolë që quhet “klauzola e stabilizimit” ose e “stabilitetit”, e cila detyron qeverinë që të mitigojë koston e shtuar nëpërmjet ndryshimit të një takse. Pra, për të qenë shumë të qartë edhe teknikisht, edhe parimisht do të isha shumë i lumtur që rentën për eksport të naftës bruto ta rrisnim.

Blerina Gjylameti- E kisha për të gjithë gamën, jo vetëm për një nga gamat.

Arben Ahmetaj – Ajo që na takon të diskutojmë dhe besoj se është detyra jonë, është nëse ka përpunim vendas ose jo. Pra, nëse ka përpunim vendas, do të ishte me vlerë të bënim diferencën, por edhe sipas logjikës suaj të nxitjes diferencimi mund të ishte një nga instrumentet e nxitjes. Kështu që ne do ta shohim dhe, kur të diskutohet nen për nen, do të vijmë me një logjikë pak më të gjerë se kromi dhe ferrokromi.

Blerina Gjylameti- Unë e vlerësoj shumë këtë masë të ndërmarrë. Synimin për të pasur një vlerë të shtuar të produktit, sidomos të produkteve të industrisë nxjerrëse, e vlerësoj shumë dhe propozoj që kjo të zgjerohet më tutje, ekzaktësisht në këtë linjë që ju jeni.

Arben Ahmetaj- Në një pyetje të zotit Pëllumbi për qelqin bëhet fjalë kur importohet shishja si pjesë e produktit që prodhohet në vend, pra shishja e ujit, e birrës, e një lëngu frutash. Në fakt, jemi duke folur për këtë rast që vjen si pjesë e produktit final, jo si produkti final në vetvete, ne lehtësojmë koston e prodhimit vendas.

Erion Braçe- A ka pyetje të tjera?

Së pari, ajo që tha zonja Gjylameti lidhur me mbështetjen që ne i bëjmë masës që ju keni ndërmarrë për rritjen e rentës minerare për produktet e papërpunuara, në fakt, është e konsultuar me të gjithë komisionin.

Ajo që më shqetëson mua, që po e formuloj si pyetje, ka të bëjë me faktin se edhe ju si ministër i Ekonomisë besoj do t'ju interesojë ky fakt, si do të funksionojë tregu i kromit pas kësaj mase.

Arben Ahmetaj – Të paktën, për çfarë i referohemi historikisht, diferencimin në mes përdorimit në përpunimin vendas, le ta themi, pra në promovimin e industrisë vendase të përpunimit të metaleve, ne e kemi pasur 3% renta, ajo që përdoret brenda, 6% ajo që eksportohet. Shqetësimi është me 2 korsi dhe shqetësimi i parë është shpejtësia e eksportimit, pra jemi duke folur për një rezervë, e cila përfundon në afatmesëm.

Erion Braçe- Jam i qartë për këtë zoti ministër. Unë pyeta për konkurrencën në tregun e kromit.

Arben Ahmetaj – Aty do të ndalem, por do ta marr të shkallëzuar, se gjërat në integrale vijnë.

Erion Braçe- Këtë e vlerësuam si politikë. Tani dua të di si do të funksionojë tregu i kromit nga pikëpamja e konkurrencës. A do të funksionojë me çmimet e bursës, apo do të funksionojë me çmimet e imponuara nga ai që përpunon kromin në këtë vend? Kjo është pyetja.

Arben Ahmetaj– Së pari, në këtë vend nuk ka vetëm një njeri që përpunon kromin, ka më shumë se një dhe kjo është gjë e mirë. Investimi i BERZH-it në Elbasan është i një grupi shumë serioz sipërmarrësish, por nuk jam unë që t'i gjykoj këtu. Pra, po të kishte një njeri, do ta kishim shqetësimin.

Logjikimi e zonjës Gjylameti për promovimin është i saktë meqë kjo masë mbështet nga ju, atëherë i bie që ne të promovojmë zgjerimin e mëtejshëm të industrive të përpunimit të metaleve, të naftës bruto. E rëndësishme në këndvështrimin tim është që industria e përpunimit të kromit në ferrokrom ka kapur nivelet më të larta se në kohët më të lavdishme të kësaj industrie dhe jo pa arsye. Edhe në kohë të Enverit...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Më falni, po unë nuk marr përsipër t'i mbush mendjen askujt për statistikat, statistikat ma mbushin mendjen mua. Nëse statistikat tregojnë se ne e kemi kapur atë nivel sipër, presupozohet që përpunimi i metaleve i ferrokromit në rastin konkretet ka kapërcyer nivelet e para viteve '90, dhe kjo është shumë e rëndësishme, sepse është vlerë e shtuar që mbetet në ekonomi, madje është edhe sfidë. Kjo është logjika. Si do të funksionojë, kjo do të tregohet nga instrumentet e tregut përtej ministrit të Financave dhe Ekonomisë e përtej Komisionit të Ekonomisë. Nëse ka një sugjerim nga ana juaj, jemi gati ta diskutojmë.

Erion Braçe- Pyetja e dytë ka të bëjë me heqjen e taksës së karbonit për karburantet në eksport: a është mbledhur kjo taksë deri tani?

Arben Ahmetaj- Edhe është mbledhur, edhe ka konflikte gjyqësore.

Erion Braçe- Për çfarë janë konfliktet gjyqësore?

Arben Ahmetaj – Sepse ka kompani që nuk kanë rënë dakord me logjikën, me parimin.

Erion Braçe- Po kjo është në ligj, si nuk kanë rënë dakord me logjikën? Kush e vë në diskutim ligjin, se nuk e kuptoj? Cila është kompania që vë në diskutim ligjin? E kam parë që keni qenë në vështirësi edhe si administratë fiskale me këta. Çfarë janë këta? Ligji është ligj. Ligji ose zbatohet, ose për mos zbatim të ligjit përgjigjesh.

Arben Ahmetaj – Kush nuk e ka zbatuar, e kemi çuar në KLD.

Erion Braçe- Unë nuk kuptoj. Unë i di të gjitha masat që keni marrë, por unë nuk kuptoj me sa mend hidhet ligji në gjyq. Kush është gjyqtari që e merr përsipër këtë punë?

Arben Ahmetaj – Ja që ka.

Erion Braçe- Ju lutem, të gjitha rastet referojani Komisionit të Vlerësimit Kalimtar për secilin prej gjykatësve dhe prokurorëve që e kanë kthyer në biznes historinë e zbatimit të ligjit.

Arben Ahmetaj - Ia kemi çuar KLD-së.

Erion Braçe- Mos ia çoni KLD-së

Arben Ahmetaj- Përveç këtij rasti, unë kam një rast që është ekstravagant në kundërshtim me logjikën ku ministri i Financave dhe ministri i Drejtësisë kanë nxjerrë udhëzim për tarifën përmbartimore që ia jep tagrin ligji dhe ka një gjyqtare që e ka pezulluar. Pra, unë ia kam referuar KLD-së. Ky është skandal.

Edhe për ligjin që iu referuat ju kam rast konkret, janë çuar penalitetet dhe masat e fiskut në gjykatë, por gjykata i ka pezulluar. Domethënë këtu thyhet ligji në gjykatë, kjo është e vërteta dhe unë e kam bërë zakon administrativ që në raste të tilla unë informoj KLD-në.

Erion Braçe- Ministër, KLD-ja janë po këta. Këta janë barku, janë aty të gjithë bashkë.

Arben Ahmetaj— Taksa e karbonit ushtrohet mbi atë ingredient medemambiental. Në rastin konkret...

Erion Braçe- Kjo është histori tjetër, prandaj po ndryshon ligji. Por në momentin që ka një ligj në fuqi, ai ligj ose zbatohet, ose përgjigjesh për moszbatim.

Arben Ahmetaj— E qartë, por më besoni që shpeshherë gjendem përpara vendimeve të kësaj natyre, të cilat nuk i debatoj dot. Janë vendime gjykate. A e kuptoni që në aspektin administrativ është skandal të pezullosh udhëzimin e dy ministrave për tarifën përmbartimore. Diskutimi është pse ministri i Financave ka vendosur uljen e tarifave në kurriz të qytetarëve që marrin shërbim përmbartimor nëpërmjet bankave për sa u përket kredive të këqija. Përballë gjykatës duart i ke të lidhura dhe e bëj me qëllim këtë. Unë kam iniciuar një udhëzim të ri për përmbartuesit me ulje sërish 5%.

Erion Braçe— A ka pyetje të tjera?

A ka diskutime të tjera?

Për ta mbyllur, zoti Ministër, unë jam një nga njerëzit e shumtë të maxhorancës që kanë qenë kundër atij modeli të ndërtimit të të gjithë industrisë nxjerrëse në këtë vend, e materializuar te vrimat e pafundme që janë në Bulqizë e sipër Bulqizës. Natyrisht, ai lloj modeli edhe nuk funksionon, edhe ka sjellë konflikt, edhe nuk ka sjellë zhvillim, por ama ky është një realitet sot në industrinë nxjerrëse të vendit për sa kohë që asnjë nga autoritetet nuk ka marrë masa që këto vrima t'i reduktojë për t'i vënë nën kontroll, dhe, natyrisht, për t'ia nënshtruar një plani të qartë

zhvillimi, sepse të gjitha janë nënkontrata dhe pjesa dërrmuese e tyre nuk respektojnë as pikat e kontratës. Nuk e diskutoj këtë pjesë, as politikën që ju keni ndërmarrë, që të themi të drejtën e kemi lançuar që në vitin 2013, për nxitjen e përpunimit dhe krijimit të vlerës së shtuar, përtej punësimit por edhe të vlerës së shtuar nga pasuritë tona kombëtare, për t'i dhënë fund asaj historisë së zhvatjes të pasurive tona kombëtare.

Nga ana tjetër më intereson konkurrenca në këtë treg, kështu që shqetësimi për të cilën formulova pyetjen është prezent, pa diskutim që do t'ia përcjellim Autoritetit të Konkurrencës që këtë treg, pas hyrjes në fuqi të këtyre masave, ta monitorojë në mënyrë konstante, por natyrisht që do të jetë shqetësim i çdo autoriteti tjetër funksionimi normal në kushte konkurrence i këtij tregu.

Gjithashtu, po e përsëris edhe një herë çështjen e kësaj marrëdhënie që krijohet midis ligjit, atyre që ligji iu adresohet dhe gjykatave që marrin përsipër të sfidojnë ligjin që nuk janë gjykata Kushtetuese, por të zakonshmet dhe jo vetëm në atë rastin e tarifave të përmbarimit, por edhe në raste të tjera që vërtet ju jeni në hall në raport me këta. Çdo çështje duhet t'i referohet Komisionit të Pavarur të Rivlerësimit Kalimtar të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, me qëllim që ai komision të marrë në shqyrtim jo vetëm pasuritë e këtyre njerëzve, por edhe vendimmarrjet e tyre në sfidim të ligjeve të këtij vendi.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Ekonominë dhe Financat

PROCESVERBAL

Tiranë, më 07.11.2018, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Erion Braçe – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Projektligji “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar””

Marrin pjesë:

Erion Braçe, Anastas Angjeli, Evis Kushi, Antoneta Dhima, Blerina Gjylameti, Ilir Xhakolli, Xhavit Bushaj, Arben Pëllumbi, Reme Lala, Ervin Bushati dhe Roland Xhelilaj.

Mungojnë:

Jorida Tabaku, Edmond Spaho, Agron Shehaj, Fatbardha Kadiu, Nadire Meçorapaj, Dashamir Shehi, Edmond Haxhinasto dhe Përparim Spahiu.

Të ftuar:

Arben Ahmetaj - Ministër i Financave dhe Ekonomisë

Nikolla Lera - Drejtor i Përgjithshëm i Politikave Makroekonomike në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Endrit Lami – Drejtor i Politikave Makroekonomike në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Enkeleda Kuci -

Arbër Lleshi – këshilltar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Erion Braçe- Kalojmë te projektligji për taksat vendore.

Arben Ahmetaj – Ndryshimet, në fakt, janë në harmonizim me legjislacionin në fuqi. Nuk preken shkallët aktuale të taksave vendore, por ka lehtësim në kuptimin e interpretimit ligjor të disa dispozitave të veçanta, që në administrim kanë dalë problematike sa i përket kuptueshmërisë nga disa njësi vendore.

Ndryshimet dhe shtesat në ligj synojnë që dispozitat e ligjit të bëhen të kuptueshme, siç e thashë, dhe të zbatueshme. Në të njëjtën kohë ka një harmonizim, në këndvështrimin tim, më të saktë me ligjet: për vetëqeverisjen vendore, për financat vendore, që është një ligj i ri, i cili po maturohet këtë vit, për ndarjen administrative-territoriale të njësive të qeverisjes vendore, për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë, të ndryshuar, disa ndryshime në sistemin e taksave vendore, zbatimi i pikës 6 shkronjat “ë” dhe “g” të nenit 22, duke saktësuar rastin e përjashtimeve nga taksa e ndërtesës për kategorinë e pensionistëve dhe të ndërtesave kulturore. Ne duam të saktësojmë që të gjithë pensionistët e vetëm janë të përjashtuar nga taksa për ndërtesën. Çfarë do të thotë pensionistët e vetëm? Pensionistë të vetëm janë ata që nuk kanë persona në ngarkim që janë të punësuar, që janë të aftë për punë, por që mund të kenë në ngarkim persona të paaftë për punë. Gjithsesi, duhet parë i gjithë saktësimi dhe ta vendosim së bashku.

Harmonizohen detyrat e Drejtorisë së Përgjithshme të Taksë Pasurisë me detyrat që kanë njësitë e vetëqeverisjes vendore. Kategorizon, kjo besoj se ka ardhur nga ju si shqetësim, madje ju, zoti kryetar, e keni ngritur si shqetësim disa herë këtë çështje, llojet e investimeve në zbatim të nenit 27. Taksa e ndikimit në infrastrukturë rregullon kategorizimin e investimeve dhe pikat 2 dhe 3 për taksimin e drejtë të tyre, rregullon përcaktimin e taksës së tabelës në një nen të vetëm, si dhe administrimin nga njësitë e vetëqeverisjes vendore. Aktualisht janë dy nene, neni 32 dhe 32/1, të cilat nuk japin përkufizimin e plotë të taksës dhe mënyrën e administrimit të saj nga njësitë vendore.

Në kuadër të krijimit të kadastrës fiskale rregullon nevojën e përditësimit të të dhënave të Drejtorisë së Përgjithshme të Taksës së Pasurisë me të dhënat e regjistrit të pronës që jepen nga ZVRPP-të, taksa e tabelës në një nen të vetëm, rregullon kuptimin e taksës, objektin e zbatimit të taksës, kategorizimet për efekt taksimi, dallimin e tabelave sipas kategorive për vendosjen e taksës, menaxhimin e mbledhjes së taksës, diskrecionin e bashkisë për administrimin e tabelës

së taksës. Në të njëjtën kohë zgjidh edhe konfliktin midis operatorëve të rrjeteve kabllore me njësitë e vetëqeverisjes vendore, në rastin e vendosjes së tarifës vendore për përdorimin e infrastrukturës tokësore për shtrirjen e rrjeteve kabllore. Kufizon vendosjen e tarifës për këto rrjete vetëm në rastet kur subjektet përdorin infrastrukturën e ndërtuar nga njësitë vendore, sepse nuk është normale ta tarifojë për diçka që nuk është fare e tyre, shqetësim ky i ngritur vazhdim edhe nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, si dhe subjektet investitore. Tarifat vendosen jo në përputhje me kriteret e vendosura në ligjin nr. 68/2017 dhe vendosja e tarifave jo në bazë të kriterëve ligjore pengon investimet për zgjerimin e rrjeteve kabllore.

Pra, këto ishin elementet që ne kemi prekur te ligji i financave vendore.

Erion Braçe – Po, zonja Gjylameti.

Blerina Gjylameti – Faleminderit, zoti kryetar!

Sa i takon projektligjit “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar”, dua t’ju them se ky projektligj konkretisht synon harmonizimin në tërësi të ligjit jo vetëm me ndryshimet e shumta që ka pësuar ai, por edhe me ligjet e tjera pjesë e kuadrit rregullator për organizimin dhe funksionimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, duke propozuar që në nenet 1, 2, **3** dhe 13 ndryshimin e unifikimit të terminologjisë. Ndërsa në nenet 3, 6, 7 dhe 14 propozohet riformatimi i 4 anekseve të ligjit në përputhje me ndarjen e re administrative territoriale dhe shfuqizimi i 3 të tjerave, siç është edhe aneksi për taksën e regjistrimit të përvitshëm të mjeteve të transportit rrugor, aneksi për taksimin e biznesit të vogël dhe aneksi për nivelin tregues të taksës së zënies së hapësirës publike, në përputhje me ndryshimet që kanë pësuar dhe dispozitat referencë e të cilave kanë qenë anekset e përmendura.

Gjithashtu, saktësimin e dispozitave që trajtojnë përjashtimin nga taksa e ndërtesës për kategorinë e pensionistëve dhe ndërtesave kulturore me qëllim kufizimin e rasteve për shmangien nga pagimi i kësaj takse. Kështu në nenin 4 propozohet që të përjashtohen jo vetëm ndërtesat e banimit të familjeve që përbëhen vetëm nga pensionistë, por edhe të familjeve të pensionistëve që kanë persona të tjerë në ngarkim, të cilët janë të paaftë për punë, por vetëm për ato ndërtesa të deklaruara si vendbanim.

Po në nenin 4, propozohet që ndërtesat kulturore, sipas legjislacionit në fuqi për monumentet e kulturës, të trashëgimisë kulturore të përfitojnë përjashtimin nga taksa e ndërtesës vetëm për rastet kur këto ndërtesa përdoren për qëllime jofitimprurëse. Riformulimin e pikave 1,

2, 3 të nenit 27 me qëllim qartësimin e dispozitës që trajton taksën e ndikimit në infrastrukturë. Në pikën 2 të riformuluar, propozohet të shtohet një paragraf, sipas të cilit shkalla e taksës së ndikimit në infrastrukturë për ndërtimet zëvendësuese për qëllime banimi të kushtëzuara për t'u ndërtuar si shkak i zbatimit të një kontrate koncesionare, e cila prek banesat ekzistuese dhe ndërtimet e destinuara për qendra tregtare apo të biznesit, do të jenë në masën 4 deri në 8% të çmimit të shitjes për metër katrorë. Në pikën 3, shkronja "a", të riformuluar propozohet që përveç ndërtesave në sektorin e turizmit, industrisë dhe ndërtesave për qëllime publike të taksohen në shkallën 1 deri në 3%, 2 deri në 4% për Bashkinë e Tiranës edhe ndërtesat e sektorit të bujqësisë, ndërtesat individuale për qëllime të përdorimit vetjak nga individët qofshin këto të ndërtuara nga vetë individi apo nga ndonjë sipërmarrës. Ndërsa për ndërtesat që janë në proces legalizimi, dispozita e riformuluar kushtëzon marrjen e lejes së legalizimit vetëm pasi të jetë vërtetuar pagesa e taksës prej 0,5% të vlerës së investimit.

Rishikimin e dispozitave që trajtojnë taksën e tabelës në përputhje me ndryshimet dhe kategorizimet e miratuara vitin e shkuar në aneksin 7, taksa e tabelës sipas kategorive të bashkive. Në nenin 10 të projektligjit specifikohet që taksa e tabelës do të llogaritet mbi bazë vjetore, me përjashtim të rasteve kur tabela orientuese të taksohet sipas kategorisë së tabelave për qëllime reklamimi, pra më shumë.

Riformulimin e pikës 4 të nenit 35, ku përcaktohen tarifat vendore nëpërmjet propozimit për vendosjen e tarifës vetëm në rastin kur subjektet e rrjeteve kablllore telefonike ndërlidhëse apo të shërbimit informatik përdorin tubacione, kanale dhe rrjetet e tjera infrastrukturore, të cilat janë ndërtuar dhe janë në pronësi të njësive të qeverisjes vendore. Gjithashtu, dispozita vendos kushtin që të ardhurat nga këto tarifa të shërbejnë për përballimin e shpenzimeve, për mirëmbajtjen e rrjetit në përdorim. Ndryshimet e sipërpërmendura së bashku me ndryshimet e tjera të bëra në korrik të këtij viti për përjashtimin nga taksa e ndikimit në infrastrukturë dhe nga taksa e investimeve në infrastrukturë të strukturave akomoduese, të certifikuara, si agroturizmi, kompletojnë politikat e qeverisë në drejtim të zgjerimit të të ardhurave tatimore vendore dhe nxitjen e përmirësimit të klimës së biznesit.

Për këto arsye i ftoj kolegët deputetë ta miratojmë në parim projektligjin, duke shtuar edhe një propozim sa i përket rishikimit të taksës së ndikimit në infrastrukturë për zonat rurale.

Jam duke folur për shtëpitë e banimit në zonat rurale, por kur ta diskutojmë nen për nen, të shohim konkretisht se si mund ta saktësojmë.

Faleminderit!

Erion Braçe – Faleminderit, zonja Gjylameti!

A ka pyetje?

Urdhëroni, zonja Dhima.

Antoneta Dhima – Faleminderit, zoti kryetar!

Zoti Ministër, gjatë periudhës nga buxheti i vitit që ne kemi miratuar për 2018-n dhe deri tani nga organet e vetëqeverisjes vendore a ka pasur propozime për ndryshime të sistemit të taksave vendore dhe nëse ka pasur, sa janë marrë ato parasysh nga ana juaj? Gjithashtu, ju para disa ditësh keni bërë një takim me gjithë drejtuesit në lidhje me buxhetin për vitin 2019.

Arben Ahmetaj – Faleminderit!

Nuk ka pasur asnjë kontestim të kategorizimeve, sepse metodologjia vendos vlerën si bazë, pra vlerën reale dhe kategorizimet janë të gjitha të përshkallëzuara me zona të ndryshme, ku merret parasysh edhe ajo që iu referua zonja Gjylameti, zonat rurale, ndërkohë që toka bujqësore është e përjashtuar.

Pra, nga ky moment edhe meraku që ka zonja Gjylameti, është reflektuar në metodologji. Patjetër që mund të ndërhysh në metodologji, por nuk mund të ndërhysh në metodologji, ndërkohë që metodologjia e ka realizuar atë qëllim që ne kemi merak. Ka vetëm një kërkesë dhe kjo kërkesë na ka ardhur nga kryetari i bashkisë, por ka ardhur nga një deputet i qarkut të Vlorës, për Bashkinë e Delvinës që është kategorizuar në kategorinë dytë. Deputeti mendon që Bashkia e Delvinës është shumë e varfër, ndërkohë që duhet thënë që metodologjia lejon rivlerësimin e zonave në reflektim të shitjeve konkrete të kadastruara, që do të thotë, për këtë po ju jap një shembull konkret. Pra, në zonën iks, metodologjia ka reflektuar një çmim reference, shitjet dhe blerjet që ndodhin në atë zonë kadastrale mund të reflektohen, duke ulur ose rritur vlerën referente të asaj zone. Në rastin konkret kjo do të thotë, po marr Delvinën, dhe shitjet brenda zonimit janë në referencë 100 mijë lekë, po e marr si shembull, por transaksionet që ndodhin në atë zonë e çojnë në 110 vlerën mesatare, ky informacion nuk vjen nga Ministria e Financave, por vjen nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, nga bashkitë, atëherë reflektohet vlera e re, 110-a. Në qoftë se vlera është 90 metodologjia të detyron që të taksohesh jo mbi 100-en, por mbi 90-en, sepse është një transaksion konkret i verifikuar.

Fjalja e fundit: kryetarët e bashkive në tërësi janë shumë të kënaqur, sepse është instrumenti bazë i të ardhurave të tyre. Kërkesën që kishin, sepse nuk e donin OSHE-në si

agjentin e vetëm, ne e reflektuam dhe i kemi lënë ata të zgjedhin midis OSHE-së dhe një agjenti që ata mendojnë se e bën punën më mirë se OSHE-ja.

Blerina Gjylameti – Zoti Ministër, unë realisht e vlerësoj punën e bërë pas miratimit të reformës administrative-territoriale për adresimin e një sërë problematikave që ishin ngritur, gjithashtu edhe adresimin për diferencimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë sipas bashkive dhe kategorizimin e tyre. Meraku që unë kam është se ata banorë do të paguajnë më pak, por synimi duhet të jetë që të mos kemi një braktisje të zonave të caktuara. Pra, ne duke ulur taksën e ndikimit në infrastrukturë në disa zona apo edhe duke e zëruar në disa zona të tjera, të mos bëjmë atë çka po ndodh rregullisht, ku për disa zona kemi një braktisje të mirëfilltë, jo vetëm për shkak të kësaj gjëje, por për shkak të disa problematikave të tjera. Nga njëra anë e vlerësojmë punën që po bëhet nga qeveria për politikën e “100 fshatrave”, pra duke e rikthyer fshatin në qendra të mirëfillta të zhvillimit ekonomik, rural, bujqësor, kulturor, mendoj se duhet vazhduar me këtë politikë në mënyrë të tillë që të jemi në të njëjtën linjë.

Faleminderit!

Arben Ahmetaj – Kini parasysh që është vetëm 1% e preventivit, i cili kërkon edhe një element tjetër, por atë diskutim nuk dua ta hap këtu. A ka banesa bosh në fshat? Braktisja nuk vjen për shkak se nuk ka shtëpi, por duke thënë këtë, politika nxitëse nuk shkon te taksa e infrastrukturës dhe tek 1%-shi i preventivit, ky është një besim imi. Përderisa ka në fshat shtëpi të braktisura ose bosh, problemi nuk qëndron se aty nuk ndërtohet pasi këta paguajnë 1% të preventivit, sepse nëse ka zona në Shqipëri që ndërtohet pa fund janë fshatrat, sepse janë zona që tërheqin ekonomikisht, tërheqin turistët e të tjera. Ka disa zona që janë malore, të cilat për shkak të zhvillimit ekonomik të infrastrukturës e të tjera, ku nuk ndërtohet, jo për shkak të 1%-shit, por për shkak të zhvillimit ekonomik. Unë besoj që zhvillimi ekonomik duhet të adresohet me instrumente të tjera dhe jo me taksën e infrastrukturës.

Erion Braçe – A ka pyetje të tjera? Jo.

Kam unë dy pyetje, zoti Ministër. Ju thoni në relacionin që e shoqëron projektligjin, i cili më pas materializohet edhe në nenet që keni propozuar, që rrjetet kabllore telefonike ndërlidhëse apo të shërbimit informatik u nënshtrohen tarifave vendore në rastin kur subjektet përdorin rrjete infrastrukturë të tilla, si: tubacione, kanale e të tjera që janë ndërtuar dhe që janë në pronësi të njëjësive të vetëqeverisjes vendore. Pyetja ime është: po për ato rrjete që janë ajrore, sepse ai është problemi më i madh që ne kemi sot? Pra, për sa kohë kemi këto rrjete ajrore nuk po ndërtohen

rrjetet nëntokësoret dhe kemi këtë lloj situatë që kemi tashmë, jo vetëm nëpër qytete, por edhe nëpër fshatra.

Arben Ahmetaj – Në këtë aspekt, dua t’ju them se ato nuk janë objekt i taksimit, por kjo nuk ka rëndësi. Dua t’ju them se ajo që ju thoni është serioze, por besoj se adresohet me akt administrativ jo me akt ligjor. Ajo që ju po thoni është estetikisht, por edhe me risk për shëndetin dhe jetën e...

Erion Braçe – Nuk kanë as cilësi.

Arben Ahmetaj – Patjetër. Të jem i sinqertë, këtë moment nuk kam një instrument dhe t’ju thosha: “Po e kam një instrument dhe hajt t’i këpusim”. Unë propozimin tim e kam, por ai është jashtë ligjit të taksave.

Erion Braçe – Është diçka e mirë që janë bërë definicionet e reja për taksën e ndërtesës, por dua të di, a ka hyrë ligji në fuqi, apo jo?

Arben Ahmetaj – Patjetër!

Erion Braçe – Për kategoritë që ne i kemi lehtësuar ka hyrë në fuqi dhe po zbatohet?

Arben Ahmetaj – Po.

Erion Braçe – Në qoftë se zbatohet, në rregull. Do të mbledh disa fatura për këtë.

Arben Ahmetaj – T’ju bëj një sqarim për pyetjen. Është detyra e njësisë vendore që t’i përjashtoj...

Erion Braçe – Prandaj ju pyeta. Në qoftë se ligji ka 6 muaj që ka hyrë në fuqi dhe ata vazhdojnë të marrin taksën, më vjen keq, por cilado bashki të jetë më e bukura...

Arben Ahmetaj – Kjo nuk ka rëndësi, por më duhet t’ia kreditoj pastaj në qoftë se e kanë mbledhur gabim...

Erion Braçe – Patjetër, t’ia akreditosh që ç’ke me të...

Arben Ahmetaj – ...sepse këta janë të përjashtuar. Megjithatë, në dijeninë time, pasi kam me folur me përfaqësues të disa bashki të mëdha janë të përjashtuar, pra kategoritë që ne i kemi përjashtuar këtu.

Erion Braçe – Faleminderit!

A ka pyetje të tjera? Jo.

A ka diskutime për këtë projektligj? Nuk ka.

Atëherë, diskutimi në parim i këtij projektligji mbyllet këtu.

Nesër në orën 10:00 do të fillojmë me ligjin për tatimin mbi vlerën e shtuar, të ndryshuar. Do të vijojmë me ligjin për miratimin e niveleve të tarifës doganore, me ligjin për akcizat në Republikën e Shqipërisë, të ndryshuar, dhe me ligjin për procedurat tatimore.

Para se ta mbyll mbledhjen, zoti Ministër, e lamë që ju të na sillni të dhënat për çështjen e dividendit për 100 shoqëritë me xhiro më të madhe vjetore, këto të paktën për vitin 2017, por ka të drejtë, zoti Bushati, edhe për 100 aksionerët më të mëdhenj në këtë vend.

Ndërkohë, ju kemi kërkuar tabelën fiskale nga viti 1996 e këtej, por nuk e kemi marrë ende, pasi do të vijmë te diskutimi i buxhetit dhe kjo tabelë do të na duhet.

Arben Ahmetaj – Do të mundohem që sot t’ju vijë ’96-ta, por po patëm 100 më të mëdhenjtë kemi konsekuativisht edhe aksionerët. Nuk është e thënë të jenë të njëjtët...

Erion Braçe – Praktikisht, ka aksionarë që kanë disa kompani, prandaj është mirë që t’i kemi këto të dhëna.

Arben Ahmetaj – Ne do të marrim se kush ka shpërndarë dividendë, aksionerët më të mëdhenj dhe kompanitë. Kush ka përfituar dividendë nga aksionerët, Ervin Bushati, të gjithë, si dhe kush kompani ka shpërndarë dividend...

Erion Braçe – Patjetër!

A e di se çfarë merakui kam unë, të dalin deputetë, sepse ata deputetë e kanë zgjidhur, nuk vijnë për të votuar, por unë do t’i nxjerr nga salla përjashta, sepse janë në konflikt të pastër interesi.

Arben Ahmetaj – Zoti kryetar, ju kuptova! Unë e di se përse e keni kërkuar ju atë të aksionerëve, prandaj ju referova Ervinit si...

Erion Braçe – Mbledhja mbyllet këtu.

Faleminderit!

MBYLLET MBLEDHJA